

Tiranë më 4 korrik 2024

Drejtuar: Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3
Tiranë, Shqipëri

Lënda: **Komente mbi:** Projekt-Ligj Nr. /2024, për një ndryshim në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", ndryshuar me ligjin nr.10297 datë 08.07.2010 dhe me ligjin 47/2016)

Të nderuar,

Organizata profesionale “Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar”, e njohur me shkurtimin “IEKA”, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr.3573, datë 16.10.1998, është një organizmi profesional, që grupon audituesve ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, dhe që mban dhe gjirin e saj, në datën e kësaj letre, **560** anëtarë Auditues Ligjorë, aktive, jo aktive dhe kandidatë.

IEKA, duke vlerësuar përpjekjet për përafrimin e legjislacionit referues të profesionit të audituesit ligjor me

- **Direktivën 2014/56/EU¹** e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 16 April 2014 i cili ndryshon direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 17 maj 2006, “Mbi auditimet ligjore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara” dhe
- **Teksti i Konsoliduar²:** Rregullorja (BE) Nr.537/2014 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 16 prill 2014, “Mbi kërkesat specifike në lidhje me auditimin e Njësive Ekonomike me Interes Publik” dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionit 2005/909/KE”,
- **Teksti i Direktives 2006/123/EU³ “Për shërbimet”:** e cila synon heqjen e pengesave për ofrimin e shërbimeve dhe thjeshton procedurat administrative për ofruesit e tyre, zgjeron të drejtat e konsumatorëve dhe bizneseve që marrin shërbime dhe nxitjen bashkëpunimin midis vendeve të BE;

ka analizuar ndryshimet e projekt-ligjit të hedhura për konsultim publik, **me qëllim ofrimin e rekomandimeve të cilat,**

- bazohen në eksperiencën e deri tanishme të IEKA në kontributin mbi përpjekjet për harmonizimin me legjislacionin e BE në kuadrin rregullator të auditimit ligjor;
- integrojnë objektivat e zhvillimit që ka përqaftuar organizata profesionale e audituesve ligjore dhe e shoqërive të auditimit IEKA.

Rekomandimet, e paraqitura në këtë dokument, kanë për qëllim që të sigurojnë profesionistët e auditimit ligjor në lidhje me:

- Ekzistencën e një organizmi profesional që grupon audituesi ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, dhe që garanton, nëpërmjet organizimit të saj ligjor, objektivat kryesore të hyrjes në profesion, rritjes së vijueshme profesionale, përshtatshmërinë e sistemeve e menaxhimit të kontrollit të cilësisë së auditimit dhe reduktimin e kostove të auditimit;
- Rritjen e numrit të shoqërive që janë objekt i shërbimeve të auditimit, dhe njëkohsisht rritjen e numrit të shërbimeve të disponueshëm për audituesit ligjorë, me qëllim sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të anëtarëve dhe krijimin e kushteve për arritjen e cilësisë së

¹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32014L0056>

² <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02014R0537-20240109>

³ Screening Report : On the Implementation of the EU Services Directive : in the Republic of Albania : December 2022

- procesit të auditimit, të edukimit profesional dhe të kontrollit të cilësisë;
- Ekzistencën e një procesi dhe autoriteti mbikqyrje publike i cili garanton cilësinë e procesit të auditimit të shoqërive në Shqipëri,
 - Rritjen e besimit të publikut në raportimin financiar të këtyre shoqërive, zhvillimin e tregjeve të borxhit dhe të kapitalit në Shqipëri dhe integrimin e tyre me tregjet e huaja, dhe në tërësi qëndrueshmërinë e sistemit financiar, zhvillimin ekonomik të vendit kundrejt rregullimit të drejtë, bashkëkohor të profesionit, dhe
 - Siguruar nje proces transparent të evidentimit dhe sanksionimit në rast të shkeljeve, aplikimit të parimit të proporcionalitetit në sanksionim e tyre dhe sigurimin e garancive për një procesi të dukur ankimi;

Duke marrë në konsideratë ndryshimet e shpeshta të ligjit Nr. 10091 nga aprovimi i tij i parë në vitin 2009 dhe nevojën për përputhjen tërësore me legjislacionin European ne fuqi, **IEKA mendon që është e udhës dhe rekomandon që të realizohet një ligj tërësisht i ri për auditimin ligjor dhe mbikqyrjen e profesionit** me qëllim që të realizohet objektivi i rëndësishëm i integritetit sa i takon tregjeve dhe kapitalit dhe përfaqësjes me legjislacion European në kuadër të procesit të integritetit.

Megjithatë, bazuar në projekt-ligjin e vënë në dispozicion për konsultim publik, rendisim propozimet e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (në vijim “IEKA”), të cilat i kemi grupuar në përputhje me kapitujt e ligjit aktual dhe ndërlidhjen midis propozimeve të cilat paraqiten gjithësisht në dokumentin bashkëlidhur.

Një përmbledhje të propozimeve i gjeni në tabelën 1

Table 1: Përmbledhje e Propozimeve IEKA

Nr	Neni sipas Projekt-Ligjit	Përmbledhje Propozimeve IEKA	Faqja
1)	Propozimi 1 dhe 2: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 2) Sjell ndryshime në Neni 4: Pavarësia dhe funksionet e Bordit të Mbikqyrjes Publike	1. Përfshirja e dispozitave për administrimi e BMP;	Fq. 8, 9
2)	Propozimi 3: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 13) Sjell ndryshime në Neni 38 Sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë	2. Nuk mendojmë që ndryshimi i statusit juridik influencon pavarësinë në vendimmarrje të BMP;	Fq. 11
3)	Propozimi 4 : Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 14) Sjell ndryshime në Neni 39 Sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë	3. Përfshirja e delegimit të Kontrollit të Cilësisë në ligj për NJEJIP, në përputhje me praktikën e BMP të vendeve të BE dhe eksperiencës dhe aftësive të siguara prej më shumë se 15 viteve (1995-2009) dhe përditësuar të IEKA’s për vetërregullim;	Fq. 13
4)	Propozimi 5: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 12) Sjell ndryshime në Neni 37 Standardet e Auditimit	4. Korrigjime të nenit të projekt-ligjit në përputhje me propozimin 3;	Fq. 13
5)	Propozimi 6: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 8) Sjell ndryshime në Neni 32: Etika dhe Papajtueshmëria	5. Publikimi i Standardeve rekomandohet të mbetet me organizatën profesionale, pjesë e praktikës ndërkombëtare: shëmbull FNK e cila realizon publikimin e standardeve ndërkombëtare të Bordeve përkatëse;	Fq. 15
6)	Propozimi 7: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 1) Sjell ndryshime në Neni 2 Përkufizime	6. Korrigjuar me qëllim reflektimin e propozimeve 1-5;	Fq. 16
7)	Propozimi 8: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 3) Sjell ndryshime në Neni 4/1 Financimi i Bordit të Mbikqyrjes Publike	7. Korrigjuar me qëllim reflektimin e propozimit 5;	Fq. 17
		8. Rekomandojmë që financimi i BMP të mos mbështetet në masën 100% nga kontributet e organizatat profesionale, audituesit ligjore dhe shoqëritë e auditimit. Përthithja e fondeve po vë në rrezik vijimësinë të organizatave, dhe shton kostot e	

Nr	Neni sipas Projekt-Ligjit	Përmbledhje Propozimeve IEKA	Faqja
		auditimit; ndërkaq që nuk sigurohet pavarësia nga influencat jo të duhura të BMP nga audituesit ligjore dhe shoqëritë e auditimit;	
8)	Propozimi 9: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 4) Sjell ndryshime në Neni 37: Të drejtat dhe detyrat e bordit të mbikëqyrjes publike	9. Saktësim i objektit të aprovimeve në përputhje me rekomandimet në këtë dokument;	Fq. 20
9)	Propozimi 10: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 5) Sjell ndryshime në Neni 7: Organizimi i audituesve ligjorë dhe i shoqërive audituese	10. Propozimi i IEKA shkon përtej propozimit për konsultim. Ofron ndryshime të cilat sigurojnë lehtësi në ndryshime statutoire pa pasur nevojën për nderhyrjen në ligj, ndërkaq që miratimi i statutit të mbetet sic ishte, kompetencë e Ministrisë të Financave;	Fq. 21
10)	Propozimi 10 : Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 6) Sjell ndryshime në Neni 12 Kompetencat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë		Fq. 25
11)	Propozimi 11: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 9) Sjell shtesa në Neni 32: Etika dhe Papajtueshmëria- <i>Skepticizmi Profesional</i>	11. Nuk ka komente.	Fq. 25
12)	Propozimi 12: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 10) Sjell ndryshime në Neni 33: Konflikti i Interesit	12. Propozimi i IEKA për forcimin e pavarësisë dhe objektivitetit, dhe në veçanti kërcënimi dhe frika është njohja e faturës së shërbimi si titull ekzekutiv;	Fq. 25
13)	Propozimi 13: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 11) Sjell ndryshime në Neni 36: Rregullat e Auditimit	13. Propozim për forcimin e regjistrimit të shkeljeve dhe mbajtjes së tij nga audituesit dhe shoqëritë e auditimit në përputhje me Rregulloren 537/2014 të BE;	Fq. 27
14)	Propozimi 14: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 15) Sjell ndryshime në Neni 41: Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare	14. Rekomandohet rritja e gamës së shërbimeve, duke ngarkuar audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit për realizimin e shërbimit të rishikimit të raportimit financiar për shoqëritë që plotësojnë vetëm një nga kushtet e detyrimit për auditim, me qëllim rritjen e cilësisë dhe sigurisë së raportimit financiar të shoqërive;	Fq. 30
		15. Rekomandohet bashkëpunimi i përkohshëm jo më pak se 3 vjet i audituesve për angazhime NjEIP, ku bashkëpunimi duhet të jete real. Mos zbatimi është objekt i sanksioneve.	
		16. Rekomandohet që në kushtet aktuale të tregut NjEIP të realizohen nga bashkimet e përkohshme sa më lart dhe shoqëritë e auditimit;	
15)	Propozimi 15: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 7) Sjell ndryshime në Neni 24: Heqja e së drejtës për të kryer shërbimin e auditimit ligjor për shoqëritë audituese dhe audituesit ligjorë	17. Rekomandojme përcaktim i fushës, që është ajo e veprëve penale në fushën e auditimit ligjor dhe aplikimi i parimit të prezumimit të pafajësisë.	Fq. 34
16)	Propozimi 16: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 19) Sjell ndryshime në Neni 55: Shkeljet dhe masat disiplinore	18. Rekomandohet një ndryshim tërësor i nenit 19 dhe rrjedhimisht 2 neneve vijuese 20 dhe 21, si rrjedhojë e fakteve vijuese;	Fq. 34
17)	Propozimi 16: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 20) Sjell ndryshime në Neni 55: Shkeljet dhe masat disiplinore	a) nuk merr në konsideratë shkallën e shkeljes dhe të shpeshësisë së ndodhjes së shkeljes; b) mbart disporpcion në lidhje me masën e	Fq. 34

Nr	Neni sipas Projekt-Ligjit	Përmbledhje Propozimeve IEKA	Faqja
18)	Propozimi 16: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 21) Sjell ndryshime në Neni 57/1: E drejta e ankimit	sanksioneve që vendosen duke rekomanduar reduktimi i tyre për plotësimin e këtyre kushteve;	Fq. 34
19)	Propozimi 17: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 16) Sjell ndryshime në Neni 42: Emërimi i audituesve ligjorë ose i shoqërive audituese	19. Propozimi përfshin ndarjen e konceptit të emërimit nga angazhimi, duke siguruar që emërimi për një periudhë jo më pak se 3 vjet, me qëllim rritjen e parashikueshmërisë së të ardhurave. 20. Rekomandohet që të sigurohet rotacioni faktik brenda shoqërive të auditimit;	Fq. 42
20)	Propozimi 18: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 17) Sjell ndryshime në Neni 46: Komiteti i Auditimit i Personave Juridikë	21. Rekomandojmë shfuqizimin tërësor të nenit 46 dhe përfshirjen e kërkesave të Direktivës dhe Rregullores të BE në ligjin “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare. Ky kalim do të evitojë interferencat që sjell ky nen i ligjit të auditimit me legjislacionin për Bankat në Republikën e Shqipërisë, Shoqëritë e Sigurimit dhe Rissigurimit, Institucionet Financiare JoBankat etj, të cilat kanë të inkuorporuar që në gjenezën e tyre komitetet, të cilët funksionojnë në bazë të detyrave sipas ligjit dhe rregulloret përkatëse të BoA dhe AMF.	Fq. 43
21)	Propozimi 19: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 18) Sjell shtesa në Neni 46/1: Rishikimi i kontrollit të cilësisë së angazhimit	22. Rekomandojmë që neni 18 mos të merret në konsideratë, duke qënë që standardet e auditimit, dhe standardet e menaxhimit të kontrollit të cilësisë janë mjaftueshme të qartë, ndërkaq që ky nen kështu si është paraqitur rrit kostot e shërbimit për Audituesit Ligjorë PF dhe shoqëritë e auditimit me një ortak angazhimi.	Fq. 44
22)	Propozimi 20: Ndryshim ne Neni 15, Pika 1, gërma c) fjalia e 1re dhe 2 te Praktika profesionale dhe Hyrja në profesion dhe Neni 18 pika 3;	23. Propozim i ri i IEKA’s me qëllim reduktimin e barrierave ne hyrjen në profesion në përputhje me Teksti i Direktives 2006/123/EU, gjetjet e analizës së legjislacionit në Shqipëri të financuar nga GiZ , Screening Report : On the Implementation of the EU Services Directive : in the Republic of Albania : December 2022; faqja 52 seksioni, Auditing and accounting services; dhe përjashtimet tashmë të njohura në ligj a. Njohja e përjashtimit nga disa nga provimet e kualifikimit për shtetasit e huaj: neni 18 pika 10; b. Regjistrimi i shoqërive të huaja të auditimit: Neni 2, pika 21; c. Regjistrimi i Audituesve Ligjorë të juridiksioneve të huaja: neni 22; d. Njohja e edukimit profesional të realizuar nga shtetasit shqiptarë pranë palëve të treta jo IEKA; Neni 15, pika 7	Fq. 47 Fq. 48

Propozimet sa paraqitur në tabelë janë përgatitur bazuar në analizën e neneve individuale të

përcjella me projekt-ligjin, nenet e ligjit aktual 10091 të cilat;

a) janë krahasuar me

- legjislacionin European, sa më sipër cituar
- rezultatet e publikuara të anketave të realizuara nga Accountancy Europe⁴,
- rezultatet e studimit mbi statusin e implementimit të legjislacionit European për auditimin ligjor⁵, dhe

b) me fokus primar në

- kushtet specifike ekonomike dhe sociale në të cilat ndikojnë profesionin në vend;
- nevojat dhe kërkesat për zhvillimin e profesionit, reduktimin e kostove të biznesit dhe sigurimin e kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm të profesionit që të mundësojmë;
 - Zhvillimin personal nëpërmjet edukimit dhe nxënies së vijueshme profesionale të anëtarëve;
 - Rritjen ekonomike, duke ndihmuar në rritjen e të ardhurave të anëtarëve dhe rrjedhimisht në ekonominë vendase;
 - Rritjen dhe promovimin e inovacionit dhe zhvillimit teknologjik të audituesve ligjor;
 - Forcimin e rolit të gruas në profesion dhe reduktimin e pabarazive midis anëtarëve;
 - Rritjen dhe bashkëpunimin institucional kundrejt kontributit në përmirësimin e kuadrit rregullator të profesionit dhe të legjislacionit të biznesit në tërësi;
 - Rritjen e respektimit të ligjit nga anëtarët dhe njësitë ekonomike për të cilat ofrojmë shërbimet në funksion të kuadrit rregullator në fuqi;
 - Sigurimin e kushteve për rritjen e mirëqënies së anëtarëve dhe familjeve të tyre;

Bashkëlidhur Propozimet individuale

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

Berti PASHKO

Kryetar

Këshilli Drejtues

⁴ Organisation of the Public Oversight of the Audit Profession in Europe: State of affairs after the implementation of the 2014 Audit Reform,

⁵ <https://ec.europa.eu/sites/default/files/study-on-the-audit-directive-200643ec-as-ev0120603enn.pdf>

Përmbledhja e Propozimeve

1. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 që prekin Aktivitetin, organizimin e BMP dhe Përgjegjësitë mbi Kontrollin e Cilësisë.....	7
Propozimi 1 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 2 i Projekt-Ligj Nr. /2024	8
Propozimi 2 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 2 i Projekt-Ligj Nr. /2024:	9
Propozimi 3 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 13 i Projekt-Ligj Nr. /2024	11
Propozimi 4 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 14 i Projekt-Ligj Nr. /2024	13
Propozimi 5 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 12 i Projekt-Ligj Nr. /2024	15
Propozimi 6 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 8 i Projekt-Ligj Nr. /2024	15
Propozimi 7 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 1 i Projekt-Ligj Nr. /2024	16
Propozimi 8 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 3 i Projekt-Ligj Nr. /2024	17
Propozimi 9 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 4 i Projekt-Ligj Nr. /2024	20
2. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 kreu III Organizata Profesionale e Audituesit Ligjor dhe e Shoqerive Audituese.....	21
Propozimi 10 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 5 dhe neni 6 i Projekt-Ligj Nr. /2024.....	21
3. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 kreu IV Audituesi Ligjor dhe Shoqeria e Auditimit	25
Propozimi 11 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 9 i Projekt-Ligj Nr. /2024 – shtesë Neni 32/1 Skepticizmi Profesional	25
Propozimi 12 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 10 i Projekt-Ligj Nr. /2024	25
Propozimi 13 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 11 i Projekt-Ligj Nr. /2024	27
Propozimi 14 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 15 i Projekt-Ligj Nr. /2024	30
4. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 kreu VIII Shkeljet dhe Sanksionet.....	32
Propozimi 15 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 7 i Projekt-Ligj Nr. /2024	34
Propozimi 16 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 19, 20,21,22 i Projekt-Ligj Nr. /2024.....	34
5. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 kreu V Auditimi Ligjor i Pasqyrave Financiare, Emërimi dhe shkarkimi i Audituesit Ligjor dhe i Shoqërisë së Auditimit.....	42
Propozimi 17 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 16 i Projekt-Ligj Nr. /2024	42
6. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 kreu VI Dispozita të veçanta për Auditimi Ligjor të Njesive me Interes Publik	43
Propozimi 18 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 17 i Projekt-Ligj Nr. /2024	43
Propozimi 19 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 18 i Projekt-Ligj Nr. /2024	44
Propozimi 20 IEKA: Ndryshimi i Propozuar nga IEKA Neni 15 pika 2 gërma c fjalë e parë dhe e dytë	47
Propozimi 20 IEKA: Ndryshimi i Propozuar nga IEKA Neni 18 pika 3	48

1. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 që prekin Aktivitetin, organizimin e BMP dhe Përgjegjësitë mbi Kontrollin e Cilësisë

- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 2) Sjell ndryshime në Neni 4: Pavarësia dhe funksionet e Bordit të Mbikëqyrjes Publike**
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 13) Sjell ndryshime në Neni 38 Sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë**
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 14) Sjell ndryshime në Neni 39 Sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë**
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 12) Sjell ndryshime në Neni 37 Standardet e Auditimit**
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 8) Sjell ndryshime në Neni 32: Etika dhe Papajtueshmëria**
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 1) Sjell ndryshime në Neni 2 Përkufizime**
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 3) Sjell ndryshime në Neni 4/1 Financimi i Bordit të Mbikëqyrjes Publike**
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 4) Sjell ndryshime në Neni 5: Të drejtat dhe detyrat e bordit të mbikëqyrjes publike**

Propozimi 1 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 2 i Projekt-Ligj Nr. /2024***Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 2) Sjell ndryshime në Neni 4: Pavarësia dhe funksionet e Bordit të Mbikëqyrjes Publike***

Është i rëndësishme realizimi i një ndryshim të mëtejshëm të ligjit me qëllim e organizimit të BMP, përkatësisht në lidhje me:

- a) **Administrimin dhe menaxhimin financiar në përputhje me Ligjin Nr. 10 296, datë 08.07.2010 I ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar”, për të garantuar qq menaxhimi financiar dhe kontrolli i BMP është në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi, në veçanti neni 1 gërma 20, neni 19 dhe neni 20 gërma c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.**
- b) **Transparencën në Administrimin e aktivitetit të BMP dhe specifikisht në lidhje me publikimin e raporteve vjetore të:**
 - I. ***Raportimin e vendimarrjeve të Bordit dhe publikimin e tyre në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë***, në përputhje me praktikës e zbatuar nga entet shtetërore të cilat publikojnë aktë zyrtare të zbatueshme nga publiku, ku publiku i BMP përfshin Audituesit Ligjore, Shoqëritë e Auditimit, Njësitë me Interes Publik, Njësitë Ekonomike Jo me Interes Publik autoritet Mbikqyrëse të Njërive Ekonomike me Interes Publik etj.
 - II. ***Raportimit Financiar përgjatë periudhës ushtrimore*** dhe veprimeve që ka ndërmarrë menaxhimi për të marrë siguri që burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike.
 - III. ***Raportimin e Aktivitetit të Publike*** sa i takon Mbikqyrjes së Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë të Njërive Ekonomike me Interes Publik të ngritur nga audiuesit ligjore dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë.
 - IV. ***Këshillimin dhe Mbikqyrjen e Bordit*** duke krijuar një mekanizëm që të mbikqyrjes së veprimtarisë së Bordit Mbikëqyrjes Publike.

Sa parashtuar më lart IEKA rekomandon që keto elemente të merren në konsideratë në vijim të nenit 5 duke shtuar një nen të ri 5/1 i titulluar: Organizimi i Bordit të Mbikqyrjes Publike.

Propozimi 2 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 2 i Projekt-Ligj Nr. /2024:

Me tej në lidhje me opcionin e zgjedhur nga legjislativi për të krijuar një autoritet të pavarur për mbikqyrjen e profesionit, bazuar në ligjin 10091 të vitit 2009, deshirojmë të nënvizojnë që bazuar në eksperiencën e vendeve anëtare⁶,

Figure 1: Status i Krijimit te auditoriteteve te mbikqyrjes se profesionit -Qershor 2022

Status of countries' audit oversight body

	Separate autonomous audit oversight body	Audit oversight body operating within/attached to a ministry	Audit oversight under an authority/market authority with wider competences
COUNTRY	Austria, Belgium, Bulgaria, Cyprus, Czech Republic, Estonia, France, Germany, Greece, Iceland, Ireland, Luxembourg, Malta, Poland, Slovakia, Slovenia	Croatia, Denmark, Hungary, Italy (for audits/auditors of non-PIEs), Latvia, Lithuania, Romania, Spain, Sweden	Finland, Italy (for audit/auditors of PIEs), the Netherlands, Norway, Portugal, the UK
	TOTAL 🇫🇮 = 16	TOTAL 🇫🇮 = 9	TOTAL 🇫🇮 = 6

përzgjedhja e autoritetit që do të ngarkohet sipas ligjit merr në konsideratë;

- Shkalla e zhvillimit financiar dhe specifikisht: huamarrësve, huadhënësve, kuadri rregullator dhe ofruesit e liquiditetit (money-market, tregu i bonove të thesarit, tregu primar i obligacioneve shtetërore dhe ai sekondar, tregu primar i obligacioneve korporative dhe ai sekondar, dhe tregu i kapitalit)
- Madhësia e ekonomisë e cila përfshin dhe,
 - o Numrin e njësive ekonomike (2023:226,778⁷) dhe respektivisht numrin e njësive ekonomike të cilat janë objekt i shërbimit të auditimit (2023:3.779⁸)
 - o Numrin e profesionistëve të auditimit dhe shoqërive të auditimit ligjor aktivë (2023: 167 Auditues Ligjorë aktive dhe 70 shoqëri auditimi);
 - o Numri i organizatave profesionale të audituesve dhe shoqërive të auditimit 1: *IEKA*,
 - o Numri i organizatave profesionale të Kontabiilistëve të Miratuar 2: *IKM dhe SHKFSHI* (2024: 545 KM dhe 60 Shoqëri Kontabiliteti)

Figure 2




Figure 3



Sa vërehet, nga numrat e paraqitur më lart, më pak se 2% të njësive ekonomike janë objekt i shërbimit të auditimit, dhe që plotësojnë kushtet:

- totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrijnë ose kalon shumë prej 50 milionë lekësh;
- shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhëkontabël arrijnë ose kalon shumë prej 100 milionë lekësh;
- ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

⁶ Accaountancy Europe June 2022: Public audit oversight streamlining European countries' oversight regimes

⁷ <https://ëëë.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistrat-e-biznesit/#tab3>

⁸ <https://bmp.al/ëp-content/uploads/2024/04/Raporti-Vjetor-i-veprimtarise-se-BMP-per-vitin-2023.pdf>

Ky numer shoqërish pritet të reduktohet me projekt-ligjin e mbërritur i cili rrit kufirin e numri të punonjësve nga 30 në 50:

- totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- ka, mesatarisht, të paktën 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

Numri i njësive objekt auditimi pritet të reduktohet dhe me shumë në harkun e 5 viteve në rast të transpozimit të direktivës dhe kufijve monetarë të Bashkimit European të cilat parashikojnë, (ref figura 4),

- një total bilaci 1,5 herë më të lartë se kufiri me i ulet i aplikuar aajtualisht ngë vendet e BE
- një total qarkullimi 1,6 here më i lartë së kufiri më i ulët (*shtetit që ka asetet më të ulta*)

Si rrjedhojë është e nevojshme, në reference dhe me nenin 4/1 dhe propozimet që e shoqërojnë në këtë dokument, që organet shtetërore të vlerësojnë ekzistencën e Bordit të Mbikqyrjes si njësi ekonomike e pavarur nga buxheti i shtetit dhe me personalitet juridik,

- pasi krijon ngarkesa të panevojshme mbi kostot e auditimit;
- nuk shkëputet nga konflikti i interesit si pasojë e financimit të drejtpërdrejtë nga audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit dhe organizatat profesionale.

Sa më sipër propozimi i detajuar për nenin 2 të projek-ligjit paraqitet si vijon:

ISHTE

Quote

Në fund të pikës 1 të nenit 4, ~~shtohet~~ togfjalëshi, “..., me cilësinë e personit juridik publik, me qendër në Tiranë.”

Unquote

BEHET

Quote

Në fund të pikës 1 të nenit 4, shtohet **fjalë**, Bordi i Mbikqyrjes Publike është organizëm publik në varësinë e Ministrisë së Financave dhe gëzon personalitetin juridik të Ministrisë së Financave.”

Unquote

Figure 4⁹ Informacion mbi kufijte e audiimit ne vendet e BE per vitin 2021

Table 1 - Audit exemption thresholds in 27 EU Member States, Iceland, Norway, Switzerland, Turkey and United Kingdom in 2021¹⁸

Country	Balance sheet total (EUR)	Net turnover (EUR)	Number of employees
Austria	5.000.000	10.000.000	50
Belgium ¹⁷	4.500.000	9.000.000	50
Bulgaria	1.000.000	2.000.000	50
Croatia	2.000.000	4.000.000	25
Cyprus ¹⁸	0	0	0
Czech Republic	1.500.000	3.000.000	50
Denmark a ¹⁹	537.000	1.075.000	12
Denmark b ²⁰	6.000.000	12.000.000	50
Estonia a ²¹	800.000	1.600.000	24
Estonia b ²²	2.000.000	4.000.000	50
Finland	100.000	200.000	3
France ²³	4.000.000	8.000.000	50
Germany	6.000.000	12.000.000	50
Greece	4.000.000	8.000.000	50
Hungary ²⁴	Not applicable	833.333	50
Iceland	1.400.000	2.800.000	50
Ireland	6.000.000	12.000.000	50
Italy ²⁵	4.000.000	4.000.000	20
Latvia	800.000	1.600.000	50
Lithuania	1.800.000	3.500.000	50
Luxembourg	4.400.000	8.800.000	50

⁹ <https://accountancyeurope.eu/ep-content/uploads/2022/12/Audit-exemption-thresholds-in-Europe.pdf>

Propozimi 3 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 13 i Projekt-Ligj Nr. /2024

Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 13)



Sjell ndryshime në Neni 38 Sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë

Në vijim të ndryshimit sa më sipër i nenit 2 të projektligjit dhe mendimet e parashtruara nga IEKA me sipër dhe bazuar;

- në eksperiencën e deritanishme legislative në angazhimin për rritjen e cilësisë në auditimin e Njësive Ekonomike me Interes Publik dhe Transparencën në Raportimin Financiar dhe atë të Qëndrueshmërisë të këtyre Njësive, në të cilën BMP është një nga komponentet thelbësore të arritjes së qëllimit;
- rritjes së vijueshme të numrit të Njësive me Interes Publik në Shqipëri;
- eksperiencës së Shteteve Anëtare të BE¹⁰ në mbikqyrjen e audituesve ligjore dhe shoqërive të auditimit të këtyre njësive, në të cilën Siguria mbi cilësinë për Njësitë Ekonomike Jo me Interes Publik është transferuar në mbi 50% të vendeve anëtare nga autoriteti mbikqyrës të organizatave profesionale, figura 5 në vijim;

Figure 5: Statusi i Delegimi per NjEIP:

Figure 6: Statusi i Delegimi per NjEJP



IEKA vlerëson që Ndryshimi i sjellë nenin 13 të projekt-ligjit dhe veçanërisht pika 1 gërma b) e tij,

- nuk ka njëtrajtshëmëri në lidhje me delegimet e realizuara nga Ligji të çështjeve të lidhura me mbikqyrjen.
Delegimet e dhëna tashmë organizatës profesionale të Audituesve Ligjore dhe i Shoqërive të Auditimit renditen:
 - o mbajtjen e regjistrit dhe regjistrimin e Audituesve dhe Shoqërive të Auditimit, neni 2 pika 5, neni 5 pika 1 gërma c), f) dhe neni 19;
 - o edukimin e vijueshëm profesional neni 12 pika 2 gërma c) dhe;
 - o standardet profesionale neni 37 të ligjit në fuqi;
- nuk reflekton në delegimin e detyrave nga BMP të organizatave profesionale përputhje me eksperiencën e vendeve anëtare të BE¹¹, dhe në veçanti të vendeve të BE nga të cilat rrjedh pjesa më e rëndësishme e investimet e huaja direkte në Shqipëri: Francë, Gjermani, Itali, Greqi, Norvegji, Hollandë dhe UK.

Sa më sipër **Propozimi 3 i IEKA rekomandon ndryshime të cilat**

- integrojnë delegimin e Sigurimit të Cilësisë së Auditimit për njësitë ekonomike JO me Interes Publik të Organizatave Profesionale të Audituesve Ligjore dhe i shoqërive të auditimit IEKA;
- caktojnë kushtet e përgjithshme për sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë e auditimit ligjor në tërësi të cilat janë të zbatueshme dhe nga organizatave profesionale të cilës i delegohet Siguria mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë.

¹⁰ Organisation of the Public Oversight of the Audit Profession in Europe: State of affairs after the implementation of the 2014 Audit Reform

¹¹ Organisation of the Public Oversight of the Audit Profession in Europe: State of affairs after the implementation of the 2014 Audit Reform

Në këtë mënyrë realizohet njëtrajtshmërinë në trajtimin e delegimeve në ligj.

Detajet e ndryshimeve që rekomandohenn në ligjin në fuqi, vijnë këtu ;

Ishte:**Quote**

Në nenin 38 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1.Pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

“1.Sistemi për sigurimin e cilësisë është i detyrueshëm për të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit. Sistemi i sigurimit të cilësisë përfshin:

a) sigurimin e cilësisë, që organizohet brenda audituesit ligjor ose shoqërisë audituese; dhe është objekt i mbikëqyrjes publike;

b) sigurimin e cilësisë, që organizohet nga BMP. BMP mund të delegojë tek organizata profesionale e audituesve ligjorë kryerjen e kontrollit për sigurimin e cilësisë të njësive ekonomike që nuk janë me interes publik. BMP mbikëqyr këtë proces dhe revokon delegimin, kur e vlerëson të nevojshme.”.

2.Pika 2 ndryshon si më poshtë vijon:

“2.Sistemi i sigurimit të cilësisë që organizohet nga BMP duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:

a) sistemi për sigurimin e cilësisë duhet të organizohet në mënyrë që të jetë i pavarur nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese;

b) financa për sistemin e sigurimit të cilësisë duhet të jetë i sigurt dhe i lirë nga çdo ndikim i mundshëm dhe i papërshtatshëm nga audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese;

c) sistemi për sigurimin e cilësisë duhet të mbështetet në burime dhe kapacitete të mjaftueshme;

ç) individët që kryejnë kontrollin e sigurimit të cilësisë duhet të kenë arsimin përkatës profesional dhe përvojën e duhur në auditimin ligjor, raportimin financiar, dhe ku është e zbatueshme, në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë apo shërbime të lidhura me të, të kombinuar me trajnime të posaçme për rishikimin e cilësisë në lidhje me auditimin ligjor.”.

3.Pika 3 ndryshon si më poshtë vijon:

“3.BMP miraton rregulloren dhe metodologjinë e detajuar për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit të angazhuar në auditimin e njësive ekonomike me interes publik dhe jo me interes publik.”.

Unquote**Të bëhet:****Quote**

Në nenin 38 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1.Pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

“1.Sistemi për sigurimin e cilësisë është i detyrueshëm për të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit. Sistemi i sigurimit të cilësisë përfshin:

a) sigurimin e cilësisë që organizohet nga audituesit ligjor ose shoqëritë audituese i cila është objekt i marrjes së sigurisë mbi cilësinë;

b) sigurimin e cilësisë i njësive ekonomike që nuk janë me interes publik delegohet të realizohet tek organizata profesionale e audituesve ligjorë me qëllim marrjen e sigurisë për sigurimin e cilësisë të këtyre njësive ekonomike.

c) sigurimin e cilësisë i njësive ekonomike që janë me interes publik realizohet nga Bordi i Mbikqyrjes Publike me qëllim me qëllim marrjen e sigurisë për sigurimin e cilësisë të këtyre njësive ekonomike.

2.Pika 2 ndryshon si më poshtë vijon:

“2.Sistemi i sigurimit të cilësisë i ngritur sa më sipër duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:

a) sistemi për sigurimin e cilësisë duhet të organizohet në mënyrë që të jetë i pavarur nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese të cilat do të kontrollohen;

b) sistemi i sigurimit të cilësisë duhet të jetë i sigurt dhe i lirë nga çdo ndikim i mundshëm dhe i papërshtatshëm nga audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese të cilët janë objekt i kontrollit;

c) sistemi për sigurimin e cilësisë së auditimit ligjor duhet të mbështetet në burime dhe kapacitete të mjaftueshme njerëzore;

ç) individët që kryejnë kontrollin e sigurimit të cilësisë duhet të kenë përvojën e duhur në auditimin ligjor jo me pak se 3 (vite) vite dhe të jenë Auditues Ligjorë jopraktikues;

d) individët që kryejnë kontrollin e sigurimit të cilësisë në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë duhet të kenë marrë njohuri profesionale nga insitucione të njohura arsimore dhe profesionale në fushën e standardeve të qëndrueshmërisë specifiku në qeverisje, ambientin dhe burimet njerëzore, dhe të kenë përvojën e duhur jo me pak se 1 (një) vit;

e) individët që kryejnë kontrollin e sigurimit të cilësisë në dhënien e sigurisë të shërbime të lidhura, duhet të kenë të kenë përvojën e duhur në raportimin dhe kontrollon financiar, menaxhimin financiar dhe në auditim jo me pak se 5 (pesë) vite dhe të jenë Auditues Ligjorë jopraktikues.

3.Pika 3 ndryshon si më poshtë vijon:

“3.BMP miraton rregulloren dhe metodologjinë e detajuar për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit të angazhuar në auditimin e njësive ekonomike me interes publik.

4.Pika 4 zëvendësohet si më poshtë vijon:

4.Organizata Profesionale e Audituesve Ligjore dhe i shoqërive të auditimit miraton rregulloren dhe metodologjinë e detajuar për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit të angazhuar në auditimin e njësive

Pjesa vijuese e nenit 38 për të cilën nuk ka pasur propozime ndryshimi

- ~~4 Sistemi i dhënies së sigurisë për cilësinë, që kryhet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, nëpërmjet delegimit, organizohet në mënyrë që të jetë i pavarur nga audituesit ligjorë apo shoqëritë e auditimit, të cilat kontrollohen.~~
- ~~5 Bordi miraton rregulla të hollësishme për organizimin e kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike jo me interes publik.~~
- ~~6 Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton metodologjinë e kontrollit të cilësisë për strukturën mbështetëse.~~
- ~~7 Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, që kryejnë auditime ligjore të njësive ekonomike me interes publik, si dhe të njësive ekonomike që nuk janë me interes publik, janë objekt i kontrollit të cilësisë nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike apo nga organizata profesionale e audituesve ligjorë në rastet kur kryerja e kontrollit të cilësisë i delegohet kësaj të fundit.~~

ekonomike jo me interes publik.”.

Pjesa vijuese e nenit 38 propozohet të ndryshohet si vijon

5. Bordi merr dijeni për rregulloren e depozituar nga organizata profesionale për organizimin e kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike jo me interes publik.

Pika 6 zëvendësohet si më poshtë vijon

6. Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë dhe i shoqërive të auditimit sigurohet që të publikojë aktivitetin e kontrollit të cilësisë që realizon përgjatë periudhës ushtrimore brenda muajit Maj të çdo viti, në përputhje me rregulloren përkatëse.

Pika 7 shfuqizohet

Unquote

Propozimi 4 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 14 i Projekt-Ligj Nr. /2024

Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 14)

Sjell ndryshime në Neni 39 Sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë

Me tej, në kuadër të ndryshimeve që rrjedhin nga propozimi 3 më lart, IEKA rekomandon që të ndërhyhet në versionin e sjellë për mendim , i cili ndryshon nenin 39 të ligjit në fuqi si vijon:

ISHTË: quote

Neni 39 ndryshon si më poshtë:

1. “**BMP** organizon sistemin e sigurimit të cilësisë në mënyrë të pavarur nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese të kontrolluar.
2. **BMP** ngre një sistem efektiv të kontrollit të sigurimit të cilësisë së auditimit ligjor.

BMP do të kryejë kontrole të sigurimit të cilësisë të shoqërive audituese që kryejnë auditime ligjore mbi bazën e një analize të rrezikut dhe:

- a) në rastin e shoqërive audituese që kryejnë auditime ligjore të NJEIP të paktën një herë në tre vjet; dhe,
- b) në raste të tjera nga ato të përmendura në germën (a), të paktën një herë në gjashtë vjet.
3. Objekti i kontroleve duhet të mbulojë të paktën:
 - a) një vlerësim të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë të hartuar nga shoqëria audituese ose audituesi ligjor;
 - b) një testim të përshtatshëm për pajtueshmërinë e procedurave dhe rishikimin e dosjeve të angazhimit të auditimit, për të verifikuar efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë;
 - c) në kuadrin e gjetjeve të kontrollit sipas germave (a) dhe (b) të kësaj pike, një vlerësim të përmbajtjes së raportit vjetor më të fundit të transparencës të publikuar nga një

BEHET: Quote

Neni 39 ndryshon si më poshtë:

1. “**BMP dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit** organizon sistemin e sigurimit të cilësisë në mënyrë të pavarur nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese të kontrolluar.
2. “**BMP dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit** ngre një sistem efektiv të kontrollit të sigurimit të cilësisë së auditimit ligjor.
BMP dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit do të kryejë kontrole të sigurimit të cilësisë të shoqërive audituese që kryejnë auditime ligjore mbi bazën e një analize të rrezikut dhe:
 - a) në rastin e shoqërive audituese që kryejnë auditime ligjore të NJEIP të paktën një herë në tre vjet; dhe,
 - b) në raste të tjera nga ato të përmendura në germën (a), të paktën një herë në gjashtë vjet.
3. Objekti i kontroleve duhet të mbulojë të paktën:
 - a) një vlerësim të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë të hartuar nga shoqëria audituese ose audituesi ligjor;
 - b) një testim të përshtatshëm për pajtueshmërinë e procedurave dhe rishikimin e dosjeve të angazhimit të auditimit, për të verifikuar efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë;
 - c) në kuadrin e gjetjeve të kontrollit sipas germave (a) dhe (b) të kësaj pike, një vlerësim të përmbajtjes së raportit vjetor më të fundit të transparencës të publikuar nga një shoqëri audituese

shoqëri audituese ose audituesi ligjor.

4. Kontrolli duhet të mbulojë të paktën politikat dhe procedurat e mëposhtme të kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërisë audituese ose të audituesit ligjor:
- a) përputhshmërinë e shoqërisë audituese ose audituesit ligjor me standardet ndërkombëtare të zbatueshme të auditimit dhe të kontrollit të cilësisë, si dhe kërkesat mbi etikën dhe pavarësinë, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
 - b) sasinë dhe cilësinë e burimeve të përdorura, duke përfshirë përputhshmërinë me kërkesat e edukimit të vazhdueshëm profesional;
 - c) pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji për tarifat e zbatuara të auditimit.

~~Për qëllime të kontrollit të përputhshmërisë, dosjet e angazhimit të auditimit do të zgjidhen në bazë të një analize të rrezikut të dështimit për të kryer një auditim ligjor në mënyrë të përshtatshme.~~

~~BMP~~ gjithashtu do të rishikojë periodikisht metodologjitë e auditimit, të përdorura nga shoqëritë audituese për të kryer auditimet ligjore.

Përveç kontrolleve të cituara në këtë pikë, ~~BMP~~ do të ketë kompetencën për të kryer kontrolle të tjera.

5. ~~BMP~~ vendos një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve në raportin përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë. Kjo periudhë nuk duhet të kalojë 12 muaj në rastin e rekomandimeve për sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë të shoqërisë audituese.
6. Nëse rekomandimet dhe afatet e caktuara e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, nuk ndiqen për zbatim, audituesi ligjor ose shoqëria audituese do t'i nënshtrohet masave sanksionuese të parashikuara në nenin 55.
7. Afati i përfundimit të procedurave të kontrollit të cilësisë është deri në 6 muaj nga data e njoftimit për fillimin e procedurave të kontrollit.
8. Afati, sipas pikës 3 të këtij neni, mund të zgjatet me vendim të ~~BMP~~, në rast se kërkohen procedura të mëtejshme, që kanë të bëjnë me prova, të dhëna shtesë dhe ekspertizë të specializuar për shqyrtimin e rastit.
9. Në të gjitha rastet kur audituesi ligjor/shoqëria audituese e përzgjedhur për realizimin e kontrollit të sigurimit të cilësisë, refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e qëllimit të kontrollit, do të jenë subjekt i masave sanksionuese të përcaktuara në nenin 55.

Unquote

ose audituesi ligjor, nëse ka një të tillë.

4. Kontrolli duhet të mbulojë të paktën politikat dhe procedurat e mëposhtme të kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërisë audituese ose të audituesit ligjor:

- a) përputhshmërinë e shoqërisë audituese ose audituesit ligjor me standardet ndërkombëtare të zbatueshme të auditimit dhe të kontrollit të cilësisë, si dhe kërkesat mbi etikën dhe pavarësinë, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- b) sasinë dhe cilësinë e burimeve të përdorura, duke përfshirë përputhshmërinë me kërkesat e edukimit të vazhdueshëm profesional;
- c) pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji për tarifat e zbatuara të auditimit.

BMP dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit gjithashtu do të rishikojë periodikisht metodologjitë e auditimit, të përdorura nga shoqëritë audituese për të kryer auditimet ligjore.

Përveç kontrolleve të cituara në këtë pikë, BMP dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit do të ketë kompetencën për të kryer kontrolle të tjera.

5. BMP dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit vendos një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve në raportin përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë. Kjo periudhë nuk duhet të kalojë 12 muaj në rastin e rekomandimeve për sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë të shoqërisë audituese.
6. Nëse rekomandimet dhe afatet e caktuara e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, nuk ndiqen për zbatim, audituesi ligjor ose shoqëria audituese do t'i nënshtrohet masave sanksionuese të parashikuara në nenin 55.
7. Afati i përfundimit të procedurave të kontrollit të cilësisë është deri në 6 muaj nga data e njoftimit për fillimin e procedurave të kontrollit.
8. Afati, sipas pikës 3 të këtij neni, mund të zgjatet, sipas rastit, me vendim të BMP dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në rast se kërkohen procedura të mëtejshme, që kanë të bëjnë me prova, të dhëna shtesë dhe ekspertizë të specializuar për shqyrtimin e rastit.
9. Në të gjitha rastet kur audituesi ligjor/shoqëria audituese e përzgjedhur për realizimin e kontrollit të sigurimit të cilësisë, refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e qëllimit të kontrollit, do të jenë subjekt i masave sanksionuese të përcaktuara në nenin 55.

Propozimi 5 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 12 i Projekt-Ligj Nr. /2024**Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 12)****Sjell ndryshime në Neni 37 Standardet e Auditimit**

Në frymën e argumentimit të mësipërm dhe ndryshimeve të propozuar 1-4 , ju bëjme me dije se dhe propozimi i sjellë mbi ndryshimin e **Neni 37** Standardet e Auditimit të Ligjit në fuqi. **IEKA mendon që nuk ka arsye pse të ndërhyhet në nenin 37 të ligjit në fuqi.**

Ver argumentin e heres se fundit per marredhenieve me IFAC

Si rrjedhojë IEKA rekomandon disa ndryshime në versionin e sjelle për mendim të ndryshimit të nenin 37 të ligjit dhe që janë në përputhje me propozimet 1-4 parashtuar më lart.

Ishte propozimi**Quote**

Në nenin 37, pika 2, ndryshon si më poshtë vijon:
"2.Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë" (SNAS) janë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë (SNMC) dhe Standarde të tjera të lidhura me to, të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurisë (BSNAS), në masën që ato janë të rëndësishme për auditimin ligjor, të përkthyer dhe publikuar në gjuhën shqipe, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze, nën përgjegjësinë e organizatës profesionale të audituesve ligjorë, të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP."

Unquote**Vijon pika e e nenit 37 ligji në fuqi**

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë siguron përkthimin, përditësimin dhe publikimin në kohën e duhur të standardeve ekzistuese, të standardeve të reja ose atyre të rishikuara

Behet propozimi IEKA**Quote**

Në nenin 37, pika 2, ndryshon si më poshtë vijon:
"2.Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë" (SNAS) janë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë (SNMC), Standartet Ndërkombetare të Edukimit (SNE) dhe Standarde të tjera të lidhura me to, të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurisë (BSNAS) dhe të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël (BSNEK), në masën që ato janë të rëndësishme për auditimin ligjor, të përkthyer dhe publikuar në gjuhën shqipe, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze, nën përgjegjësinë e organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

Pika 3 e nenit ndryshon si vijon

Organizata profesionale e audituesve ligjorë siguron përkthimin, përditësimin dhe publikimin në kohën e duhur të standardeve ekzistuese, të standardeve të reja ose atyre të rishikuara, jo më larg së 12 muaj nga data e publikimit nga Bordet Ndërkombëtare."

Unquote**Propozimi 6 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 8 i Projekt-Ligj Nr. /2024****Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 8)****Sjell ndryshime në Neni 32: Etika dhe Papajtueshmëria**

Në frymën e argumentimit të mësipërm dhe ndryshimeve të propozuar 1-5 propozojmë që të bëhen rregullimet në nenin 8 të projekt-ligjit si vijon:

Ishte propozimi**Quote****Neni 8**

Në nenin 32, pika 1 ndryshon si më poshtë:
"1.Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit zbatojnë parimet e etikës profesionale, ku përfshihen të paktën funksioni i tyre me interes publik, integriteti, objektiviteti, aftësia profesionale dhe kujdesi i duhur, siç përcaktohet në kërkesat përkatëse të Kodit të Etikës të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës të Profesionistëve Kontabël të publikuar nga FNK, ~~të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP."~~

Unquote**Behet propozimi IEKA****Quote****Neni 8**

Në nenin 32, pika 1 ndryshon si më poshtë:
"1.Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit zbatojnë parimet e etikës profesionale, ku përfshihen të paktën funksioni i tyre me interes publik, integriteti, objektiviteti, aftësia profesionale dhe kujdesi i duhur, siç përcaktohet në kërkesat përkatëse të Kodit të Etikës të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës të Profesionistëve Kontabël të publikuar nga FNK, përkthyer dhe publikuar prej tyre në shqip nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit në bazë të marreveshjeve të lidhura për këtë qëllim me FNK.

Unquote

Propozimi 7 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 1 i Projekt-Ligj Nr. /2024**Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 1) Sjell ndryshime në Neni 2 Përkufizime****Ky ndryshim i paraqitur për diskutim:**

- përfshin ndryshime në përkufizimet e termave si auditim ligjor, auditues ligjor, shoqëri auditimi, etj. dhe
- përfshin shtesa në përkufizimet në lidhje me Auditimin e Raportimit të qëndrueshmërisë¹² në përputhje me direktivën 2022/2464 e cila ndryshon Regulloren (EU) No 537/2014, Direktiven 2004/109/EC, Direktiven 2006/43/EC dhe Direktiven 2013/34/EU, në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me raportimin e qëndrueshmërisë të njësive ekonomike (Text ëith EEA relevance)

Bazuar në argumentet e paraqitura 1-6 në rekomandojmë që ky nen të ndryshojë, në pikën 10 të tij, me qëllim njehsimin e ndryshimeve bazuar në propozimeve të IEKA 1-6, si vijon:**ISHTE PROPOZIMI****Quote**

Në nenin 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

10.Pika 17 ndryshon si më poshtë:

“17.Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë” (SNAS) janë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë (SNMC) dhe Standarde të tjera të lidhura me to, të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurisë (BSNAS), në masën që ato janë të rëndësishme për auditimin ligjor, të përkthyer dhe publikuara në gjuhën shqipe, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze, nën përgjegjësinë e OPAL, të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP.”

unquote**BEHET****Quote**

Në nenin 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

10.Pika 17 ndryshon si më poshtë:

“17.Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë” (SNAS) janë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë (SNMC) dhe Standarde të tjera të lidhura me to, të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurisë (BSNAS), në masën që ato janë të rëndësishme për auditimin ligjor, të përkthyer dhe publikuara në gjuhën shqipe, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze, nën përgjegjësinë e IEKA në cilësinë e organizatës profesionale të Audituesve Ligjorë dhe i Shoqërive të Auditimit.”

¹² Directive (EU) 2022/2464 of the European Parliament and of the Council of 14 December 2022 amending Regulation (EU) No 537/2014, Directive 2004/109/EC, Directive 2006/43/EC and Directive 2013/34/EU, as regards corporate sustainability reporting (Text ëith EEA relevance)

Propozimi 8 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 3 i Projekt-Ligj Nr. /2024

Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 3)

Sjell ndryshime në Neni 4/1 Financimi i Bordit të Mbikëqyrjes Publike

Në lidhje me këtë ndryshim, dhe në tërësi mbi nenin 4/1 të Ligjit ne si IEKA vëmë në dukje sa vijon:

- Direktiva 2014/56/EU e ndryshuar dhe Rregullorja 537/2014 e ndryshuar të BE përcaktojnë kushtin e vetëm që financimi i Autoriteteve Mbikëqyrëse duhet të jëtë i pavarur nga influencat e audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit. Si rrjedhojë legjislacionet e vendeve anëtare ofrojnë skema të ndryshme të financimit .
- Financimi i aktiviteteve mbikëqyrëse¹³ në vendet anëtare të BE përfshin një serë eksperiencash
 - Kroacia dhe Sloveni : financim nga buxheti i Shtetit,
 - Greqia: jo më shumë se 1% e angazhimeve dhe diferenca nga buxheti i shtetit
 - Franca: % mbi angazhimet,
 - Hungaria nga buxheti i shtetit dhe 10% të tarifës së anëtarësisë të grumbulluara nga organizatat e profesionistëve.

Figure 7: Permbledhje Statusit të financimit të BMP në BE, 2022¹⁴

Public oversight bodies' sources of funding

	COUNTRY	TOTAL
	Bulgaria, Croatia, Czech Republic, Latvia, Lithuania	5
	Denmark, Finland, France, Greece, Iceland, Luxembourg, the Netherlands, Norway, Spain, Sweden	10
	Belgium, the UK	2
	Estonia (state funding up to 50%), Germany, Italy, Malta, Poland (state funding only if needed), Portugal, Slovakia, Slovenia	8
	Hungary, Romania (70% state funding)	2
	Austria, Cyprus (20% state funding), Ireland (40% state funding)	3



State funding



Fees levied directly on auditors/audit firms




Fees levied on professional bodies

- Bazuar në eksperiencat e Shteteve Anëtare të BE, vendosja e masave të kontributeve të Organizatave profesionale për financimin e organizmave të caktuar për mbikëqyrjen e profesionit nuk përfshihet në ligjet e vendeve anëtare.
- Burimet e financimit të BMP në Shqipëri varen në masën 100% nga kontributet e anëtarëve të organizatave profesionale, duke vënë në rrezik në këtë mënyrë eksistencën dhe cilësisë e kërkuara nga të 2 palët : Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe Organizatat Profesionale.

Raporti Vjetor 2022¹⁵

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet struktura e financimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike:

Struktura e Burimeve




- 56% e burimeve nga tarifa 3% nga honorarët NJEIP;
- 33% e burimeve të ri alokuara nga procesi i provimeve të aftësive profesionale;
- 11% e burimeve nga tarifa 7% nga organizatat profesionale & të ardhura të tjera;

Raporti Vjetor 2023¹⁶

bmp BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Struktura e Burimeve



- ✓ 40% e burimeve nga tarifa 3% nga honorarët NJEIP;
- ✓ 30% e burimeve të ri alokuara nga procesi i provimeve të aftësive profesionale;
- ✓ 8% e burimeve nga tarifa 7% nga organizatat profesionale
- ✓ 22% e burimeve nga të ardhurat e realizuara në vitin 2023

Ne në IEKA mendojmë që;

- Rregullimi i financimit të autoritetit mbikëqyrës duhet realizohet në përputhje me planet strategjike të zhvillimit të profesionit dhe veçanërisht të BMP dhe Organizatave profesionale, duke siguruar në këtë mënyrë:**

¹³ Organisation of the Public Oversight of the Audit Profession in Europe: State of affairs after the implementation of the 2014 Audit Reform

¹⁴ Accaountancy Europe June 2022: Public audit oversight streamlining European countries' oversight regimes

¹⁵ https://bmp.al/ep-content/uploads/2023/04/Raport-Vjetor_-BMP-2022.pdf

¹⁶ <https://bmp.al/ep-content/uploads/2024/04/Raporti-Vjetor-i-veprimtarise-se-BMP-per-vitin-2023.pdf>

- Vijimësine e aktiviteti të organizatave profesionale;
- Financimin e aktiviteteve të Bordit në përputhje me planet e zhvillimit dhe buxheteve të aprovuara;
- Refletojë situatën aktuale të zhvillimit financiar të vendit, në veçanti statusin e zhvillimit të tregjës të borxhit dhe të tregut të kapitalit;
- Refletojë situatën aktuale të shoqërive me kapital vendas, sa i takon strukturës së kapitalit, të udhëheqjes dhe të transparencës dhe efektet që kjo mbart mbi profesionin e auditimit ligjor ;

Në këtë aspekt shtojmë që masa aktuale e kërkuar e të ardhurave për financimin e aktiviteti të BMP prej organizatave profesionale, e cila aktualisht nuk kufizohet vetëm në tarifën mbi angazhimet, por dhe në kalimin e tepërcave të fondeve që rrjedhin nga pranimi i kandidatëve, shtesa vjetore fondesh etj,

- shoqërohet me rritjen e kostove të auditimit,
- vendosjen në një pozicion jo konkurrues të audituesve për shkak të kostove shtesë rregullatore që i ngarkohen tarifave aktuale¹⁷, të cilat janë afërsisht, ref tabela më poshtë:
 - o qarkullimi mesatar, përgjatë 5 viteve të fundit, për një angazhim nuk tejkaluar 300 mijë Lek,
 - o qarkullimi gjithsej vjetor mesatar, përgjatë 5 viteve të fundit, nga shërbimet e auditimit nuk tejkalon 12 Milion Leke për shoqëri Auditimi dhe 3 Milion lek për Auditues Ligjor.

2) Në kuadër të aktiviteteve që parashikon ligji për auditimin, propozuar në këtë projekt-ligj;

- o Marrja e sigurisë mbi raportimin e qëndrueshmërisë
- o Rishikimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë të angazhimeve të audituesit ligjor osë shoqërive të auditimit prej auditues ligjorë jo i angazhuar në procesin e auditimit

ne vlerësojmë që audituesit dhe shoqëritë e auditimit do të shoqërohen me rritje të mëtejshme e kostove në ofrimin e shërbimit dhe do të gërryejnë me tepër bazën e fitimit neto në dispozicion të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit.

3) kostot e financimit që kërkojnë nga BMP, përfshirë dhe masat e sanksioneve të cilat janë në dispozicion me të ardhurat mesatare të audituesve ligjorë në RSH ref. seksioni vijues i komenteve, do të reduktojnë aftësinë dhe kapacitetet financiare të anëtarë të IEKA për përmirësimin, rritjen profesionale, investimet në teknologji etj.

4) është e nevojshme që të gjenden burime të tjera financimi për BMP duke mos ngarkuar me tej profesionistët dhe kostot e auditimit.

Tabela 1: të dhënat mbi vlerat mesatare të angazhimeve¹⁸

	2019	2020	2021	2022	2023
Nr Angazhimeve gjithsej	3.111	3.288	3.329	3.579	3.779
Ardhurat Mesatare per Angazhim '000Lek	304	325	349	339	339
Të Ardhura Bruto Mesatar '000Lek					
Shoqëri Auditimi	12.479	13.192	11.845	11.548	11.043
Auditues Ligjorë (PF)	2.724	2.671	3.118	3.152	3.049

Ndërkaq që nënvizojmë që vendosja e shumave, në % (përqindje) apo vlera monetare, e bën ligjin objekt të ndryshimeve, duke marrë në konsideratë që nevojat për financimin e aktiviteteve të

¹⁷ (për shembull kërkesën më e fundit e BMP për transferim të ardhurash arrin në 14% të të ardhurave të organizatës profesionale të audituesve ligjore dhe i shoqërive të auditimit duke ngarkuar në këtë mënyrë Kostot e Auditimit për njësitë ekonomike.)

¹⁸ <https://bmp.al/wp-content/uploads/2024/04/Raporti-Vjetor-i-veprimtarise-se-BMP-per-vitin-2023.pdf>

institucioneve dhe organizma profesionale ndryshojnë në përputhje me planet e tyre të zhvillimit, ndryshimet rregullatore etj.

Sa më lart IEKA propozon ndërhyrjen tërësor në nenet që mbulojnë financimin e BMP si në tabeln vijuese:

Ndryshimi i sjellë

ISHTE -Quote

Në nenin 4/1 bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 4 shtohet pas fjalës “gjimat” dhe para fjalës “derdhjet”, togfjalëshi “... e vendosura nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar,...”.

Unquote

ISHTE Neni aktual 4/1

1. Financimi i veprimtarisë së Bordit të Mbikëqyrjes Publike bëhet:

a) nëpërmjet të ardhurave të mbledhura nga:

i. pagesa prej 3 për qind, e caktuar mbi shumën e honorarit të faturuar për çdo auditim të njësive ekonomike me interes publik, të paguara nga shoqëritë audituese/audituesit ligjorë, që kryejnë auditime të njësive ekonomike me interes publik;

ii. ~~fonde të tjera, që vijnë nëpërmjet kontributit të organizatave të tjera profesionale, subjekt i mbikëqyrjes nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;~~

iii. ~~shumat që u ngarkohen audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, subjekt të masave disiplinore, për të mbuluar shpenzimet e procedurave disiplinore, të cilat vendosen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;~~

iv. ~~teprica të papërdorura nga proeset e provimit përfundimtar të kandidatëve për kontabilistë të miratuar dhe auditues ligjorë;~~

v. ~~fonde të tjera, nga burime të ligjshme, të pandikuara nga audituesit ligjorë, përfshirë, por pa u kufizuar në to, grantet e akorduara në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe mbikëqyrjes së profesionit;~~

b) nëpërmjet Buxhetit të Shtetit, sipas përcaktimeve në ligjin vjetor të buxhetit.

2. Të ardhurat e siguruara, sipas pikës 1, të këtij neni, përdoren nga bordi për financimin e veprimtarisë së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Teprica e të ardhurave, në fund të vitit buxhetor aktual, kalon në reduktim të masës së financimit nga Buxheti i Shtetit për vitin pasardhës.

3. ~~Procedura dhe rregullat e mbledhjes së të ardhurave të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, hartohen dhe miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes~~

Të realizohet ndryshim tërësor i nenit 4/1 si më poshtë vijon:

BËHET

Në nenin 4/1 bëhet ndryshimi si më poshtë

1. Financimi i veprimtarisë së Bordit të Mbikëqyrjes Publike bëhet:

a) nëpërmjet të ardhurave të mbledhura dhe që përbëhen nga:

i. pagesa e caktuar mbi shumën e honorarit të faturuar për çdo auditim të njësive ekonomike me interes publik, të paguara nga shoqëritë audituese/audituesit ligjorë, që kryejnë auditime të njësive ekonomike me interes publik, vlerë e cila do të miratohet çdo tre vjet nga BMP;

ii. nga organizata profesionale e Audituesve Ligjore dhe Shoqërive të Auditimit, vlerë e cila caktohet çdo vit me marrëveshje midis BMP dhe organizatës profesionale të Audituesve Ligjore dhe Shoqërive të Auditimit, dhe që paguhen nga organizata profesionale jo më larg se 60 ditë nga publikimi i pasqyrave financiare shenimeve shoqëruese dhe raportit të auditimit

iii. shumat që u ngarkohen audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, subjekt të masave disiplinore, për të mbuluar shpenzimet e procedurave disiplinore, të cilat vendosen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike ose nga organizata profesionale e Audituesve Ligjore dhe i Shoqërive të Auditimit. Kjo vlerë nuk mund të tejkalojë 1% të vlerës së shërbimit të auditimit objekt penaliteti. Masa totale e penalteteve të vendosura gjatë një kontrolli nuk mund të tejkalojë 1% të ardhurave totale të auditimit të realizuar nga audituesit ligjor ose i shoqërive të auditimit, objekt i kontrollit;

iv. shfuqizohet

v. ~~fonde të tjera, nga burime të ligjshme, të pandikuara nga audituesit ligjorë, përfshirë, por pa u kufizuar në to, grantet e akorduara në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe mbikëqyrjes së profesionit;~~

b) nëpërmjet Buxhetit të Shtetit, sipas përcaktimeve në ligjin vjetor të buxhetit.

2. Të ardhurat e siguruara, sipas pikës 1, të këtij neni, përdoren nga bordi për financimin e veprimtarisë së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Teprica e të ardhurave, në fund të vitit buxhetor aktual, kalon në favor të organizatës profesionale të Audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit për vitin pasardhës.

3. Procedura dhe rregullat e transferimit të të ardhurave të pikës 1 të këtij neni, pika ii) , hartohen dhe miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe Organizatës profesionale të Audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit në bazë të një kontrate vjetore .

Publike.

4. Shuma prej 30 për qind e të ardhurave të arkëtuara nga gjobat e vendosura nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar derdhet në buxhetin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

4. Shuma e të ardhurave të arkëtuara nga gjobat e vendosura nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimi dhe organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar derdhet në buxhetin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Kjo shumë vlerë caktohet çdo vit me marrëveshje midis BMP dhe organizatës profesionale të Audituesve Ligjorë dhe Shoqërive të Auditimit.

Propozimi 9 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 4 i Projekt-Ligj Nr. /2024

Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 4)

Sjell ndryshime në Neni 5: Të drejtat dhe detyrat e bordit të mbikëqyrjes publike

Me qëllim saktësimin e kuptimit të objektit të propozimit dhe integrimin me propozimeve parashtruar nga IEKA më sipër lutemi gjeni rekomandimin e IEKA sa paraqitur në tabelën këtu:

ISHTË

Quote

Në nenin 5, pika 1, pas shkronjës h), shtohen gërma i) dhe j), me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“i) harton dhe miraton pasqyrat financiare në përputhje me kërkesat përkatëse të ligjit për kontabilitetin dhe miraton audituesin ligjor ose shoqërinë audituese të tyre.”.

“j) nxjerr akte, që janë rregullat, rregulloret, urdhrat, udhëzimet, manualët apo metodologjitë, në zbatim të kompetencave të parashikuara në këtë ligj apo në legjislacionin përkatës në fuqi, për përmbushjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe për organizimin dhe funksionimin e tij. BMP është përgjegjës për publikimin e akteve rregullatore ~~në faqen e tij zyrtare.~~

Unquote

Pika 2 e nenit vijon

2. Bordi miraton statutet e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e tyre.

BEHET

Quote

Në nenin 5, pika 1, pas shkronjës h), shtohen gërma i) dhe j), me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“i) harton dhe miraton pasqyrat financiare të Bordit të Mbikëqyrjes Publike në përputhje me kërkesat përkatëse të ligjit për kontabilitetin dhe miraton audituesin ligjor ose shoqërinë audituese të tyre.”.

“j) nxjerr akte, që janë rregullat, rregulloret, urdhrat, udhëzimet, manualët apo metodologjitë, mbi funksionimin të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, në zbatim të kompetencave të parashikuara në këtë ligj apo në legjislacionin përkatës në fuqi, për përmbushjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe për organizimin dhe funksionimin e tij. BMP është përgjegjës për publikimin e akteve rregullatore në fletoren zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe faqen e tij zyrtare të internetit.”.

Unquote

Në vijim mendojmë që kjo pikë në këtë nen është ripërsëritur në nenin 7 të ligjit në fuqi dhe ndryshimeve të propozuara si rrjedhojë rekomandojmë:

Pika 2 e nenit 5 të shfuqizohet.

2. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 kreu III Organizata Profesionale e Audituesit Ligjor dhe e Shoqërive Audituese

- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 5) Sjell ndryshime në Neni 7: Organizimi i audituesve ligjorë dhe i shoqërive audituese**
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 6) Sjell ndryshime në Neni 12 Kompetencat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë**

Propozimi 10 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 5 dhe neni 6 i Projekt-Ligj Nr. /2024

Duke marrë në konsideratë që Organizata profesionale ,
neni 2 Përkufizime gërma 10 e ligjit 10091 në fuqi, njeh

- ***“Organizata profesionale e audituesve ligjorë”*** është organizmi profesional, që grupon audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.
- ***“Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar”*** është emërtimi i organizatës profesionale të audituesve ligjorë e cila është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr.3573, datë 16.10.1998.

Propozimi sipas nenit 5 të projekt-ligjit kërkon të behen ndryshime në nenin 7 Organizimi i audituesve ligjorë dhe i shoqërive audituese, duke nënvizuar **“Për të gjitha ato çështje që nuk rregullohen në këtë ligj, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri.”**

Duke njohur faktin që janë 2 ligje bazë për organizimin dhe funksionim e IEKA, Ligji i 10091 dhe kuadri rregullator për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri, **propozojmë që gjithë Kreu III të ristrukturohet me qëllim që të:**

- Sigurohet mos ndërhyrja në legjislacionin e auditimit në rast të ndryshimeve në legjislacionin e organizatave jofitimprurëse;
- Nevojat për rregullimin dhe vetërregullimin e IEKA’s shprehen në statut, dhe si rrjedhojë përcaktimet e detyrave dhe përgjegjësi, të cilat janë të përcaktuara në ligjin referues për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri nuk janë të nevojshme të përsëriten në ligjin për auditimin, pasi bën të pamundur realizimin e tyre pa ndërhyrë në ligjin e auditimit;

Sa më sipër IEKA propozon ndryshimet si vijon:

ISHTE**Neni 7****Organizimi i audituesve ligjorë dhe i shoqërive audituese**

1. Profesionistët kontabël, që e ushtrojnë veprimtarinë si auditues ligjorë, grupohen në një organizim të vetëm profesional, që rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë organizimin e veprimtarisë së profesionit të audituesit ligjor dhe që organizohet si person juridik, në përputhje me këtë ligj dhe statutin e tij. Për të gjitha ato çështje që nuk rregullohen në këtë ligj, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri”.

2. Organizata profesionale e audituesve ligjorë grupon të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, vendase e të huaja, të cilat janë regjistruar të tilla, për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara, të shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë.

3. Përveç rregullave të parashikuara nga ky ligj, statuti i organizatës profesionale të audituesve ligjorë përcakton rregulla të hollësishme për organizimin, kriteret e zgjedhjes apo emërimit, funksionimin dhe detyrat e organeve të tij. Statuti miratohet nga Ministri i Financave, ~~pasi merret mendimi paraprak nga Bordi i Mbikëqyrjes Publik.~~

Neni 8

Organizimi i organizatës profesionale të audituesve ligjorë

BEHET**Neni 7****Organizimi i audituesve ligjorë dhe i shoqërive audituese**

1. Profesionistët kontabël, që e ushtrojnë veprimtarinë si auditues ligjorë, grupohen në një organizim të vetëm profesional, që rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë organizimin e veprimtarisë së profesionit të audituesit ligjor dhe që organizohet si person juridik, në përputhje me këtë ligj dhe statutin e tij. Për të gjitha ato çështje që nuk rregullohen në këtë ligj, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri.

2. Organizata profesionale e audituesve ligjorë IEKA grupon të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, vendase e të huaja, të cilat janë regjistruar të tilla, për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara, të shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë.

3. Përveç rregullave të parashikuara nga ky ligj, statuti i organizatës profesionale të audituesve ligjorë përcakton rregulla të hollësishme për organizimin, kriteret e zgjedhjes apo emërimit, funksionimin dhe detyrat e organeve të tij. Statuti miratohet nga Ministri i Financave pasi ai ka marrë aprovimin nga Asamblea e Përgjithshme e Anëtarëve.

Neni 8

1. Organizimi i organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit IEKA realizohet me

Organet e organizatës profesionale të audituesve ligjorë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve;
- b) Këshilli Drejtues;
- c) Komiteti i Kontrollit të Brendshëm;
- d) Drejtori Ekzekutiv.

Neni 9

Asambleja e përgjithshme e anëtarëve

1. Organi më i lartë vendimmarrës është asambleja e përgjithshme e anëtarëve, e cila mbledhet të paktën një herë në vit dhe, përveç kompetencave të tjera të parashikuara nga statuti, ka edhe këto kompetenca:

a) me votim të fshehtë zgjedh anëtarët e keshillit drejtues, ndër individët që kanë paraqitur kandidaturën për këto poste, të cilët më pas zgjedhin kryetarin, zëvendëskryetarin dhe drejtorin ekzekutiv, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në statutin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

b) zgjedh anëtarët e komitetit të kontrollit të brendshëm;

2. Asambleja e përgjithshme e anëtarëve mbledhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" dhe me dispozitat e statutit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

Neni 10

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues kryen drejtimin e veprimtarisë, në pajtim me vendimet e asamblesës së përgjithshme të anëtarëve, së cilës edhe i raporton për veprimtarinë e tij.

Këshilli Drejtues përbëhet nga 7 anëtarë dhe organizohet si më poshtë:

a) Kryetari;

b) Zëvendëskryetari;

c) Anëtarë përgjegjës për çështje të tjera, të ndara sipas fushës profesionale.

2. Kryetari i Keshillit Drejtues është organi që përfaqëson organizatën profesionale të audituesve ligjorë. Ai ka, gjithashtu, kompetencën për thirrjen e asamblesës së përgjithshme të anëtarëve. Në rast pamundësie apo pengimi, zëvendëskryetari mund ta thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme të anëtarëve. Statuti mund të miratojë rregulla të tjera shtesë, për raste të tjera të thirrjes së asamblesës së përgjithshme.

3. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.

Anëtarët e tjerë të keshillit drejtues zgjidhen për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm pas kalimit të një afati katërvjeçar nga përfundimi i mandatit.

4. Kriteret e përzgjedhjes së individëve, që emërohen në keshillin drejtues, të drejtat dhe detyrimet e keshillit drejtues, veprimtaria, si dhe procedurat e vendimmarrjes së keshillit drejtues rregullohen nga statuti i organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

Neni 11

Administrimi i veprimtarisë së organizimit profesional të audituesve ligjorë

1. Administrimi i përditshëm i veprimtarisë kryhet nëpërmjet organeve administrative, që drejtohen nga drejtori ekzekutiv.

2. Funksionet në organet e zgjedhura nuk rregullohen në bazë të ndonjë kontrate punësimi. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve mund të miratojë shpërblime fikse për pjesëmarrje të personave të

përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri.

2. Organizimi i organizatës profesionale të audituesve ligjorë duhet të përmbajë përveç përcaktimeve sa pika 1 e këtij neni dhe sigurimin e përputhshmërisë në lidhje me

- a. përcaktimet mbi Komitetin për Regjistrin Publik;
- b. përcaktimet mbi Komisionin e Provimeve të Aftësisë Profesionale;
- c. përcaktimet mbi kërkesat në lidhje me sigurimin e sistemit të kontrollit të cilësisë;
- d. përcaktimet mbi kërkesat për edukimin në vijimësi.

Neni 9

Asambleja e përgjithshme e anëtarëve

1. Asambleja e përgjithshme e anëtarëve mbledhet për miratimin e raportimit të aktivitetit të strukturave drejtuese të ngritura me statut dhe që lidhen me

- a. aktivitetin e Komitetin për Regjistrin Publik
- b. aktivitetin e Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale;
- c. aktivitetet që lidhen me sigurimin e sistemit të kontrollit të cilësisë;
- d. aktivitetet që lidhen me kërkesat për edukimin në vijimësi.

Neni 10

Funksionimi i IEKA

1. Organet drejtuese të krijuara nga IEKA në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri, janë përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përcaktimeve që lindin nga ky ligj në lidhje me

- a. aktivitetin e Komitetin për Regjistrin Publik
- b. aktivitetin e Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale;
- c. aktivitetet që lidhen me sigurimin e sistemit të kontrollit të cilësisë;
- d. aktivitetet që lidhen me kërkesat për edukimin në vijimësi.

2. Shfuqizohet

3. Shfuqizohet

4. Kriteret e përzgjedhjes së individëve, që emërohen në këto organe rregullohen nga statuti i organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit IEKA.

Neni 11

Administrimi i veprimtarisë së IEKA

1. Administrimi i përditshëm i veprimtarisë kryhet nëpërmjet organeve administrative të cilat krijohen në bazë të statutit të Organizatës profesionale e audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit IEKA.

2. Shfuqizohet

3. shfuqizohet

4. shfuqizohet.

zgjedhur ose të emëruar në organet drejtuese.

- ~~3- Anëtarët e Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale, të Komitetit të Regjistrimit dhe anëtarët e komisioneve apo komiteteve, të parashikuara nga ky ligj apo nga statuti i organizatës së audituesve ligjorë, kanë të drejtën e një shpërblimi fiks për ditë të pjesëmarrjes në veprimtarinë e organit përkatës. Masa e këtij shpërblimi miratohet nga bordi, sipas propozimit të Këshillit Drejtues.~~
- ~~4- Anëtarët e organeve drejtuese të organizatës dhe të komiteteve apo komisioneve, të përmendura në pikën 3 të këtij neni, gëzojnë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të kryera prej tyre për shërbime në interes të organizatës, përkundrejt paraqitjes së dokumenteve justifikuese përkatëse.~~

Neni 12

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë ka për objekt të veprimtarisë të sigurojë ushtrimin e profesionit, në përputhje të plotë me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të tij.

2. Organizata profesionale e audituesve ligjorë ka këto të drejta e detyra:

a) harton kurrikulat për programin e përgatitjes dhe trajnimeve profesionale përkandidatët që kërkojnë të hyjnë në profesion, bazuar në standardet e pranuar ndërkombëtare të edukimit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël, dhe organizon e monitoron procesin e trajnimit;

b) harton dhe miraton rregullat e praktikës profesionale ku parashikohen hollësi për komisionin e stazhit, hyrjen në praktikën profesionale, kualifikimin, ndjekjen, raportimin, kontrollin, testimin paraprak, raportimet periodike, si dhe drejtuesit e praktikës profesionale;

c) harton programet e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të tij, përcakton rregullat për organizimin dhe monitorimin e kualifikimit të vijueshëm të tyre, ku përfshihen mënyrat dhe format e kryerjes së trajnimit, monitorimi, njohja dhe ekuivalentimi i formave të ndryshme të trajnimit, që realizohen nga palët të treta, si dhe organizon e monitoron kualifikimin e vijueshëm.

ç. "realizon kontrollin e sigurimit të cilësisë për njësitë ekonomike jo me interes publik, në përputhje me aktin e delegimit nga BMP, si edhe kryen investigimin e rasteve të shkeljeve të standardeve profesionale dhe kërkesave përkatëse të etikës, në zbatim të rregullores të investigimit e të disiplinës për aspekte brenda objektit të vet;"

d) merr pjesë në organizatat ndërkombëtare të profesionit dhe udhëheqveprimtarinë për përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga anëtarësia;

dh) mban dhe përditëson regjistrin publik të audituesve ligjorë audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese;

e) u paraqet organeve dhe institucioneve shtetërore çdo informacion për profesionin, në bazë të të cilit janë organizuar anëtarët e vet, si dhe ka detyrë të paraqitet kur thirret nga këto organe e autoritete për çështje që kanë të bëjnë me këtë profesion;

ë) siguron se anëtarët e tij zbatojnë praktikën më të mira në fushën e standardeve profesionale dhe të etikës;

f) kryen çdo detyrë tjetër, që është brenda objektit të veprimtarisë, të përcaktuar në këtë ligj dhe në statut;

g) përgatit aktet vetërregulatore dhe/ose akte të tjera nënligjore, në zbatim të këtij ligji, të cilat i nënshtrohen miratimit, sipas

Neni 12

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë IEKA ka për objekt të veprimtarisë të sigurojë ushtrimin e profesionit, në përputhje të plotë me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të tij.

2. Organizata profesionale e audituesve ligjorë IEKA ka këto të drejta e detyra:

a) harton kurrikulat për programin e përgatitjes dhe trajnimeve profesionale përkandidatët që kërkojnë të hyjnë në profesion, bazuar në standardet e pranuar ndërkombëtare të edukimit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël, dhe organizon, monitoron dhe vlerëson procesin e trajnimit;

b) harton dhe miraton rregullat e praktikës profesionale ku parashikohen hollësi për komisionin e stazhit, hyrjen në praktikën profesionale, kualifikimin, ndjekjen, raportimin, kontrollin, testimin paraprak, raportimet periodike, si dhe drejtuesit e praktikës profesionale;

c) harton programet e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të tij, përcakton rregullat për organizimin, monitorimin dhe vlerësimin e kualifikimit të vijueshëm të tyre, ku përfshihen mënyrat dhe format e kryerjes së trajnimit, monitorimi, vlerësimi, njohja dhe ekuivalentimi i formave të ndryshme të trajnimit, që realizohen nga palët të treta, si dhe organizon e monitoron kualifikimin e vijueshëm.

ç. realizon kontrollin e sigurimit të cilësisë për njësitë ekonomike jo me interes publik, si edhe kryen investigimin e rasteve të shkeljeve të standardeve profesionale dhe kërkesave përkatëse të etikës, në zbatim të rregullores të investigimit e të disiplinës për aspekte brenda objektit të vet;

d) merr pjesë në organizatat ndërkombëtare të profesionit dhe udhëheqveprimtarinë për përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga anëtarësia;

dh) mban dhe përditëson regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese;

e) paraqet organeve dhe institucioneve shtetërore çdo informacion për profesionin, në bazë të të cilit janë organizuar anëtarët e vet, si dhe ka detyrë të paraqitet kur thirret nga këto organe e autoritete për çështje që kanë

~~rastit, nga bordi dhe/ose Ministri i Financave.~~

3. Statuti parashikon organet e ngarkuara për plotësimin dhe ndjekjen e secilës prej detyrave dhe kompetencave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 13

Burimet dhe përdorimi i të ardhurave

~~1. Pasuria e organizatës profesionale të audituesve ligjorë përbëhet nga:~~

- a) gjendja e trashëguar nga veprimtaria e Institutit të Audituesve Ligjorë;
- b) të ardhurat nga kuotat, që paguajnë anëtarët e tij, të cilat përcaktohen sipasstatutit;
- c) shumat e arkëtuara për gjokat dhe penalitetet e vendosura ndaj anëtarëve tëtij, në rast të shkeljeve disiplinore;
- ç) të ardhurat nga veprimtari të tilla, si publikimi i materialeve, kualifikimi istazhierëve dhe i vijueshëm, si dhe shërbime që kryen për të tretët;

d) të ardhurat nga investimet e aktiveve;

dh) donacionet, projektet dhe të ngjashme, të dhëna në kuadër të zhvillimit tëprofesionit;

e) të ardhura të tjera nga burime të ligjshme.

~~2. Vendimarrja për përdorimin e fondeve i nënshtrohet dispozitave të statutit tëorganizatës.~~

Neni 14

Procedurat e investigimit dhe të marrjes së masave disiplinore

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë vë në funksionim një sistem efikas investigimi dhe monitorimi të disiplinës, si dhe respekton procedurat e kryerjes së investigimit, me qëllim zbulimin, korrigjimin dhe parandalimin e mangësive, që mund të vërehen gjatë kryerjes së shërbimit të auditimit ligjor dhe të shërbimeve profesionale të tjera dhe të lidhura nga audituesit ligjorë.

2. Rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore miratohen nga bordi, sipas propozimit të këshillit drejtues. Këshilli drejtues, kur kjo i kërkohet, vë në dispozicion stafin e vet dhe asiston bordin, me cilësinë e sekretariatiteknik.

3. Organizata profesionale e audituesve ligjorë siguron publikimin e masave të marra dhe/ose sanksioneve të dhëna nga bordi ndaj audituesve ligjorë ose shoqërive audituese.

të bëjnë me këtë profesion;

ë) siguron se anëtarët e tij zbatojnë praktikat më të mira në fushën e standardeveprofesionale dhe të etikës;

f. kryen çdo detyrë tjetër, që është brenda objektit të veprimtarisë, të përcaktuar në këtë ligj dhe në statut;

g. përgatit aktet vetërregullatore dhe/ose akte të tjera nënligjore, në zbatim të këtij ligji, të cilat i nënshtrohen miratimit në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

3. Statuti parashikon organet e ngarkuara për plotësimin dhe ndjekjen e secilës prej detyrave dhe kompetencave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 13

Shfuqizohet

Neni 14

Procedurat e investigimit dhe të marrjes së masave disiplinore

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit IEKA vë në funksionim një sistem efikas investigimi dhe monitorimi të disiplinës, si dhe respekton procedurat e kryerjes së investigimit, me qëllim zbulimin, korrigjimin dhe parandalimin e mangësive, që mund të vërehen gjatë kryerjes së shërbimit të auditimit ligjor dhe të shërbimeve profesionale të tjera dhe të lidhura nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit.
2. Rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore miratohen nga bordi, sipas propozimit të organeve drejtuese të Organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe i shoqërive të auditimit IEKA.
3. Organizata profesionale e audituesve ligjorë IEKA siguron publikimin e masave të marra dhe/ose sanksioneve të dhëna prej saj ndaj audituesve ligjorë ose shoqërive audituese.

3. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 kreu IV Audituesi Ligjor dhe Shoqëria e Auditimit

- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 9)** Sjell shtesa në Neni 32: Etika dhe Papajtueshmëria
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 10)** Sjell ndryshime në Neni 33: Konflikti i Interesit
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 11)** Sjell ndryshime në Neni 36: Rregullat e Auditimit
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 15)** Sjell ndryshime në Neni 41: Emërimi i audituesve ligjorë ose i shoqërive audituese

Propozimi 11 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 9 i Projekt-Ligj Nr. /2024 – shtesë Neni 32/1 Skepticizmi Profesional

Nuk ka Komente për këtë Propozim

Propozimi 12 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 10 i Projekt-Ligj Nr. /2024**Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 10)****Sjell ndryshime në Neni 33: Konflikti i Interesit**

Duke marrë në konsideratë që shërbimi i auditimit, *i cili njihet dhe kategorizohet si shërbim publik*, ekzpozohet ndaj riskut të likuiditetit i cili rrjedh si pasojë e mungesës së pagesës në kohë apo të mospagesës tërësorë të faturës së shërbimit të emetuar nga auditues ligjorë dhe shoqëri e auditimit, **veçanërisht në rastet e opinioneve të kualifikuar apo terheqjes së audituesit në përfundim të punës nga emetimi i raportit.**

Sa më lart me qëllim:

- Reduktimin e riskut të likuiditetit dhe reduktimi të aftësisë paguese që shoqërohet me reduktimin e kostove të formimit profesional të vetë audituese por dhe të stafeve ndihmës dhe reduktimin e përdorimit të inovacionit teknologjik në procesin e auditimit;
- Ruajtjen e pavarësisë, dhe specifikisht në zërin e kërcënimit dhe frika

IEKA rekomandon që Fatura e emetuar për shërbimet e auditimit, e cila lëshohet në përfundim të angazhimit, pranë shoqërisë së audituar, nga auditues ose shoqëri auditimit, të njihet si titull ekzekutiv i pagueshem brenda 30 ditëve nga data e lëshimit.

Sa më sipër rekomandojmë ndryshimin vijues në projekt-ligj:**ISHTË****Quote****Neni 10**

Në nenin 33 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1.Pika 4 ndryshon si më poshtë vijon:

“4. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit nuk do të pranojnë apo kryejnë auditimin ligjor, në rast se ekziston kërcënimi i vetë-rishikimit, interesit vetjak, familjaritetit dhe frikësimit të krijuara gjatë marrëdhënies financiare, personale, tregtare, të punësimit apo marrëdhënies të tjera midis:

i) audituesit ligjor, shoqërisë së auditimit, rrjetit të shoqërisë së auditimit, cildo individ, në pozicion që mund të ushtrojë ndikim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në konkluzionet e auditimit ligjor, dhe;

ii) njësisë ekonomike të audituar ku si rrjedhojë e kërcënimit, një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e informuar, duke marrë në konsideratë të gjitha masat mbrojtëse të zbatuara, arrin në konkluzionin se pavarësia e audituesit ligjor ose shoqërisë së auditimit është cenuar.”.

2.Pas pikës 6 shtohen pikat 6.1) dhe 6.2), me përmbajtje si më poshtë

BEHET**Neni 10**

Në nenin 33 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1.Pika 4 ndryshon si më poshtë vijon:

“4. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit nuk do të pranojnë apo kryejnë auditimin ligjor, në rast se ekziston kërcënimi i vetë-rishikimit, interesit vetjak, familjaritetit dhe frikësimit të krijuara gjatë marrëdhënies financiare, personale, tregtare, të punësimit apo marrëdhënies të tjera midis:

i) audituesit ligjor, shoqërisë së auditimit, rrjetit të shoqërisë së auditimit, cildo individ, në pozicion që mund të ushtrojë ndikim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në konkluzionet e auditimit ligjor, dhe;

ii) njësisë ekonomike të audituar ku si rrjedhojë e kërcënimit, një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e informuar, duke marrë në konsideratë të gjitha masat mbrojtëse të zbatuara, arrin në konkluzionin se pavarësia e audituesit ligjor ose shoqërisë së auditimit është cenuar.”.

2.Pas pikës 6 shtohen pikat 6.1) dhe 6.2), me përmbajtje si më poshtë vijojnë:

vijojnë:

“6. 1. Audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese dokumentojnë në fletët e tyre të punës së auditimit të gjitha kërcënimet/presionet e konsiderueshme, që lidhen me pavarësinë e tyre, si dhe masat e marra për shmangien e tyre.”

“6.2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, kërcënime të rëndësishme mund të konsiderohen, por pa u kufizuar, rastet që lidhen me:

- a) interesat financiare;
- b) huatë dhe garancitë;
- c) marrëdhëniet e biznesit;
- ç) marrëdhëniet familjare dhe personale;
- d) punësimi të një subjekti auditimi;
- dh) emërimi i përkohshëm i personelit;
- e) shërbimet e ofruara kohët e fundit për subjektin e auditimit;
- ë) mbajtjen e një pozicioni drejtues ose administrativ në njësinë ekonomike subjekt i auditimit;
- f) ofrimin e shërbimeve të ndryshme nga ato të sigurimit të cilësisë për një subjekt auditimi;
- g) politikat e shpërblimit dhe vlerësimit;
- gj) dhuratat dhe mikpritja;
- h) çështje gjyqësore në proces ose të pretenduara për t'u ndërmarrë.”

3.Pika 7 ndryshon si më poshtë vijon:

“7.Tarifa e auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë nuk duhet të jetë influencuar apo përcaktuar në funksion të kryerjes së shërbimeve të tjera për njësinë ekonomike të audituar dhe nuk mund të jetë bazuar në ndonjë formë tjetër kushtëzimi.”.

Unquote

“6. 1. Audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese dokumentojnë në fletët e tyre të punës së auditimit të gjitha kërcënimet/presionet e konsiderueshme, që lidhen me pavarësinë e tyre, si dhe masat e marra për shmangien e tyre.”

“6.2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, kërcënime të rëndësishme mund të konsiderohen, por pa u kufizuar, rastet që lidhen me:

- a) interesat financiare;
- b) huatë dhe garancitë;
- c) marrëdhëniet e biznesit;
- ç) marrëdhëniet familjare dhe personale;
- d) punësimi të një subjekti auditimi;
- dh) emërimi i përkohshëm i personelit;
- e) shërbimet e ofruara kohët e fundit për subjektin e auditimit;
- ë) mbajtjen e një pozicioni drejtues ose administrativ në njësinë ekonomike subjekt i auditimit;
- f) ofrimin e shërbimeve të ndryshme nga ato të sigurimit të cilësisë për një subjekt auditimi;
- g) politikat e shpërblimit dhe vlerësimit;
- gj) dhuratat dhe mikpritja;
- h) çështje gjyqësore në proces ose të pretenduara për t'u ndërmarrë.”

3.Pika 7 ndryshon si më poshtë vijon:

“7.Tarifa e auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë nuk duhet të jetë influencuar apo përcaktuar në funksion të kryerjes së shërbimeve të tjera për njësinë ekonomike të audituar dhe nuk mund të jetë bazuar në ndonjë formë tjetër kushtëzimi.”.

Shtohet pika 7.1

Tarifa orare e auditimit dhe orët e punës për realizimin e e nje angazhimi auditimi caktohen nga Ministria përgjegjëse për Financat me urdhër të Ministrit Përgjegjës.

Shtohet pika 8

8. Me qëllim ruajtjen e pavarësisë dhe objektivitetit të audituesit ligjor dhe shoqërisë së auditimit, Fatura e emetuar për shërbimet e auditimit dhe shërbimet e sigurisë së raportit të qëndrueshmërisë, e cila lëshohet në përfundim të angazhimit, pranë shoqërisë së audituar, nga auditues ligjor ose shoqëri auditimi, është titull ekzekutiv i pagueshem brenda 30 ditëve nga data e lëshimit.

Fatura lëshohet nga audituesi dhe shoqëria e auditimit në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, pavarësisht nëse opinioni mbart rezervë, refuzohet të lëshohet ose nëse audituesi dhe shoqëria e auditimit tërhiqen nga angazhimi në përputhje me këtë ligj dhe neni 37 dhe kjo faturë paguhet nga subjekti i audituar sipas përcaktimeve në këtë nen.

Unquote

Propozimi 13 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 11 i Projekt-Ligj Nr. /2024**Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 11)****Sjell ndryshime në Neni 36: Rregullat e Auditimit**

Ky nen përshkruan rregullat për auditimin, duke kërkuar që shoqëritë audituese të caktojnë ortakë kryesorë me burime dhe kompetenca të mjaftueshme për auditimet ligjore dhe raportimet e qëndrueshmërisë.

Një element tjetër i rëndësishëm i përfshirë është rendësia që theksohet ngaj cilësia, pavarësia dhe kompetencat janë thelbësore në përzgjedhjen e tyre, duke kërkuar që audituesit të dedikojnë kohë dhe burime të mjaftueshme për angazhimet dhe të mbajnë regjistra të shkeljeve, klientëve dhe ankesave. Me tej nënvizohen çështje teknike që kanë të bëjmë me dosjet e auditimit dhe raportimit, për të cilat kërkohet të dokumentohen dhe arkivohen.

Sa më sipër propozojmë disa ndryshime në projekt-ligj të cilat e përmirësojnë dhe më tej këtë nen sa i takon qartësisë dhe kuptueshmërisë.

**ISHTE
Quote****Neni 11**

Neni 36 ndryshon si më poshtë:

1. Kur auditimi ligjor apo dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë kryhet nga një shoqëri audituese, kjo e fundit cakton të paktën një ortak kryesor të auditimit apo ortak kryesor të qëndrueshmërisë, i cili mund të jetë një nga ortakët kryesorë të auditimit. Shoqëria audituese duhet t'i sigurojë ortakut kryesor të auditimit dhe ortakut kryesor të qëndrueshmërisë burime të mjaftueshme dhe personel që ka kompetencën dhe aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat në mënyrë të përshtatshme.
Në shërbimet e auditimit dhe dhënies së sigurisë, sigurimi i cilësisë, pavarësisë dhe kompetencave duhet të jenë kriteret kryesore të përdorura nga shoqëria audituese gjatë përzgjedhjes së ortakut kryesor të auditimit dhe, ku është e zbatueshme, të ortakut kryesor(të qëndrueshmërisë).
Ortakët kryesorë të auditimit dhe ortakët kryesorë të qëndrueshmërisë duhet të përfshihen në mënyrë aktive në kryerjen e auditimit ligjor dhe dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
2. Audituesi ligjor ~~i dedikon~~ kohë të mjaftueshme angazhimit të auditimit dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, si dhe duhet të caktojë burime të mjaftueshme, që t'i mundësojnë kryerjen e detyrave në mënyrë të përshtatshme.
3. ~~Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të krijojë një regjistër për çdo shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për çdo pasojë të çdo shkeljeje, duke përfshirë masat e marra për adresimin e shkeljes dhe ndryshimet përkatëse në sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë.
Ata do të përgatisin një raport vjetor që përmban një pasqyrë e të gjithë masave të marra dhe që do të shpërndahet për komunikim të brendshëm.
Në rast se audituesi ligjor ose shoqëria audituese kërkon këshillim nga ekspertë të jashtëm gjatë një angazhimi auditimi, ai/ajo duhet të dokumentojë kërkesën për këshillim dhe këshillën e marrë nga eksperti i jashtëm.~~
4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të mbajë një regjistër të klientit. Regjistri duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme për çdo klient auditimi:
 - a) emrin, adresën dhe vendndodhjen e biznesit;
 - b) në rastin e një shoqërie audituese, emrin(at) e ortakut(ve) kryesorë të auditimit dhe, ku është e zbatueshme, emrin(at) e ortakut(ve) kryesor(ë) të qëndrueshmërisë;
 - c) tarifat e aplikuar për auditimin ligjor, dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe tarifat e aplikuar për shërbime të tjera për çdo periudhë raportuese.
5. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të krijojë një dosje auditimi për çdo auditim ligjor dhe një dosje për çdo angazhim në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të dokumentojnë, në dosjet përkatëse, të paktën, vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë dhe fletët e punës në përputhje me kërkesat përkatëse të standardeve ndërkombëtare të auditimit

BËHET**Neni 11****Neni 36 ndryshon si më poshtë:**

1. Kur auditimi ligjor apo dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë kryhet nga një shoqëri audituese, kjo e fundit cakton të paktën një ortak kryesor të auditimit apo ortak kryesor të qëndrueshmërisë, i cili mund të jetë një nga ortakët kryesorë të auditimit. Shoqëria audituese duhet t'i sigurojë ortakut kryesor të auditimit dhe ortakut kryesor të qëndrueshmërisë burime të mjaftueshme dhe personel që ka kompetencën dhe aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat në mënyrë të përshtatshme.
Në shërbimet e auditimit dhe dhënies së sigurisë, sigurimi i cilësisë, pavarësisë dhe kompetencave duhet të jenë kriteret kryesore të përdorura nga shoqëria audituese gjatë përzgjedhjes së ortakut kryesor të auditimit dhe, ku është e zbatueshme, të ortakut kryesor(të qëndrueshmërisë).
Ortakët kryesorë të auditimit dhe ortakët kryesorë të qëndrueshmërisë duhet të përfshihen në mënyrë aktive në kryerjen e auditimit ligjor dhe dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
2. Audituesi ligjor i dedikon kohë të mjaftueshme angazhimit të auditimit dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, si dhe duhet të caktojë burime të mjaftueshme, që t'i mundësojnë kryerjen e detyrave në mënyrë të përshtatshme.
3. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të mbajë një regjistër të klientit. Regjistri duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme për çdo klient auditimi:
 - a) emrin, adresën dhe vendndodhjen e biznesit;
 - b) në rastin e një shoqërie audituese, emrin(at) e ortakut(ve) kryesorë të auditimit dhe, ku është e zbatueshme, emrin(at) e ortakut(ve) kryesor(ë) të qëndrueshmërisë;
 - c) tarifat e aplikuar për auditimin ligjor, dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe tarifat e aplikuar për shërbime të tjera për çdo periudhë raportuese.
4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të krijojë një dosje auditimi për çdo auditim ligjor dhe një dosje për çdo angazhim në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të dokumentojnë, në dosjet përkatëse, të paktën, vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë dhe fletët e punës në përputhje me kërkesat përkatëse të standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe raportit të qëndrueshmërisë. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ruajë çdo të dhënë dhe dokument tjetër që ka rëndësi në mbështetje të raportit të auditimit dhe për monitorimin e pajtueshmërisë me këtë ligj dhe kërkesat e tjera të legjislacionit të zbatueshëm. Dosja e auditimit dhe ajo e raportimit të qëndrueshmërisë duhet të mbyllet dhe arkivohet brenda 60 ditëve nga data e nënshkrimit të raportit të auditimit.
5. BMP ka të drejtë të kërkojë çdo informacion nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, në lidhje me mënyrën se si i përmbushin detyrimet e tyre gjatë auditimit ligjor dhe raportimin e qëndrueshmërisë. Mospërmbushja e kësaj kërkesë konsiderohet shkelje disiplinore dhe sanksionohet në përputhje me nenin 55.

dhe raportit të qëndrueshmërisë. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ruajë çdo të dhënë dhe dokument tjetër që ka rëndësi në mbështetje të raportit të auditimit dhe për monitorimin e pajtueshmërisë me këtë ligj dhe kërkesat e tjera të legjislationit të zbatueshëm. Dosja e auditimit dhe ajo e raportimit të qëndrueshmërisë duhet të mbyllet dhe arkivohet brenda 60 ditëve nga data e nënshkrimit të raportit të auditimit.

~~6. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të regjistrojë çdo ankesë të bërë me shkrim në lidhje me realizimin e auditimeve ligjore të kryera apo angazhime në raportimin e qëndrueshmërisë.~~

7. BMP ka të drejtë të kërkojë çdo informacion nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, në lidhje me mënyrën se si i përmbushin detyrimet e tyre gjatë auditimit ligjor dhe raportimin e qëndrueshmërisë. Mospërmbushja e kësaj kërkesë konsiderohet shkelje disiplinore dhe sanksionohet në përputhje me nenin 55.

Unquote

6.1. Shoqëritë e auditimit ligjor duhet të adoptojnë procedura specifike për raportimin brenda tyre, nga personeli, të veprimeve ose faktorëve që mund të përbëjnë ankesa, shkelje potenciale ose reale të disiplinës në fushën e auditimit ligjor dhe të angazhimeve që lidhen me raportin e qëndrueshmërisë.

6.2 Procedurat e parashikuara në paragrafin 6.1 duhet të jenë të përshtatshme për të garantuar:

a) Konfidencialitetin e të dhënave personale të ankimuesit dhe raportuesit dhe të personit të dyshuar për shkelje, duke respektuar rregullat që rregullojnë hetimet ose procedurat e nisura nga autoriteti gjyqësor lidhur me faktet e raportimit; identiteti i raportuesit nuk mund të zbulohet gjatë të gjitha fazave të procedurës, përveç në rastet e miratimit të tij ose kërkesës specifike të autoritetit gjyqësor.

b) Mbrojtjen e duhur të raportuesit nga veprimet hakmarrëse, diskriminuese ose të tjera të padrejta që mund të pasojnë pas raportimit.

c) Kanalin specifik, të pavarur dhe autonom për raportimin.

d) të drejtën e personit të dyshuar për shkelje për të dëgjuar para marrjes së çdo vendimi në lidhje me të, përveç të gjitha të drejtave të tij të mëtejshme për mbrojtje.

6.3 Paraqitja e një raportimi në kuadër të procedurës së parashikuar në paragrafin 6.1 nuk përbën shkelje të detyrimeve të lindura nga marrëdhëniet e punës, të kodit të etikës, konfidencialitetit dhe sekretit tregtar, përveç rasteve të raportimeve të bëra me dashje të keqe ose me informacione të rreme.

6.4 Bordi i Mbikqyrjes Publike jep udhëzimet zbatuese pas konsultimit me Organizatën Profesionale të Audituesve Ligjorë dhe i Shoqërive të Auditimit.

Në rast se audituesi ligjor ose shoqëria audituese kërkon këshillim nga ekspertë të jashtëm gjatë një angazhimi auditimi për 6.1, ai/ajo duhet të dokumentojë kërkesën për këshillim dhe këshillën e marrë nga eksperti i jashtëm për këtë qëllim.

Unquote

Propozimi 14 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 15 i Projekt-Ligj Nr. /2024

Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 15)

Sjell ndryshime në Neni 41: Emërimi i audituesve ligjorë ose i shoqërive audituese

Neni 15 i Projekt-ligjit ndryshon kufijtë, duke i rritur, që duhet të plotësojnë njësitë ekonomike të cilat janë parakusht për detyrimin e auditimit të shërbimit të auditimit ligjor.

Një ndryshim thelbësor që sillet në këtë nen është përcaktimi

- njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme mund të kryejnë auditimin nëpërmjet audituesve ligjorë ose shoqërive audituese,
- njësitë ekonomike të mëdha dhe NJEIP janë të detyruara ta kryejnë auditimin vetëm nëpërmjet shoqërive audituese.

Ku kompetencat për përcaktimin e kushteve i lihen Ministri i Financave, pas marrjes së mendimit të BMP, mund të përcaktojnë kritere shtesë për shoqëritë audituese që angazhohen në auditimin e këtyre njësive, të cilat mund të përfshijnë numrin e audituesve ligjorë, vjetërsinë dhe vlerësimin nga kontrollet e sigurimit të cilësisë.


Sa ky propozim është në kundërshtim legjislacionin në fuqi për Konkurrencën dhe krijon kushtet e përqëndrimit të mëtejshëm të tregut të auditimit, pasi eliminon konkueshmërisë midis ofruesve të shërbimit, niveli i të cilës nga të dhënat e viti 2022 dhe 2023 paraqitet si vijon::

- numri i shoqërive të auditimit që realizojnë mbi 40% të qarkullimit është vetëm 15,
- ndërkaq që numri i audituesve dhe shoqërive që kanë realizuar qarkullimin më të lartë është reduktuar në 50% në 2023 (15) krahasuar me 2022 (30),
- ndërkaq masa e qarkullimit është reduktuar vërtet në 20%, duke bërë të mundur që rritja e të ardhurave mesatarë për top audituesit, të cilët janë shoqëri auditimi të jetë më e lartë se ajo e rritjes së grupimit të njësive ekonomike të tjera.
- rritja e qarkullimit për shoqëritë e auditimit që mbajnë peshëm më të lartë në treg është në masën 60% dhe për pjesën tjetër është në masën 30%.

Tabela 2¹⁹: Të dhënat e tregut të Auditimit: Përqëndrimi i Grupimit që ka përqëndrimin më të lartë

	2022	2023
Numri i Grupimit që ka përqëndrimin më të lartë	30	15
Numri i Audituesve të Tjere të shoqërive	187	199
Qarkullimi i Grupimit që ka përqëndrimin më të lartë	668	526
Qarkullimi i Audituesve të tjere të shoqërive	546	756
% Qarkullimit		
Qarkullimi i Grupimit që ka përqëndrimin më të lartë	55%	41%
Qarkullimi i Audituesve të tjere të shoqërive	45%	59%
Qarkullimi Mesatar Vjetor mije Lek		
Qarkullimi Grupimit që ka përqëndrimin më të lartë	22.257	35.041
Qarkullimi i Audituesve të tjere të shoqërive	2.921	3.801

Tabela 2 – Renditja e shoqërive të auditimit sipas honorarëve të faturuara për shërbimet e auditimit



Sa më sipër mendojmë përcaktimet e këtij neni janë diskriminues dhe si të tillë lutemi gjeni propozimin e IEKA's i cili siguron që objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë të sigurohen dhe të krijohen kushtet që grupimi i audituesve ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të cilat kanë një vëllim vjetor metar qarkullimi për 2023 në masën 3,8 Mio Lekë të rrisë këtë të ardhur.

¹⁹ <https://bmp.al/ëp-content/uploads/2024/04/Raporti-Vjetor-i-veprimtarise-se-BMP-per-vitin-2023.pdf>

ISHTË**Neni 15**

Neni 41 ndryshon si më poshtë:

1. “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:
të gjitha njësitë ekonomike, të cilat, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:
 - i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
 - ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
 - iii. ka, mesatarisht, të paktën 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël.
2. Të gjitha njësitë ekonomike të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare si njësi ekonomike të vogla dhe të mesme mund të kryejnë auditimin nëpërmjet audituesve ligjorë apo shoqërive audituese.
Të gjitha njësitë ekonomike të klasifikuara të mëdha dhe NJEIP, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, detyrohen ta kryejnë auditimin vetëm nëpërmjet shoqërive audituese.
~~Ministri i Financave, pas marrjes së mendimit të BMP, mund të përcaktojë kritere shtesë për shoqëritë audituese që angazhohen në auditimin e njësive ekonomike të mëdha dhe NJEIP.~~
~~Këto kritere mund të përfshijnë, por pa u kufizuar, numrin e audituesve ligjorë, vjetërsinë dhe vlerësimin si rezultat i kontrolleve të mëparshme të sigurimit të cilësisë.~~

BEHET**Neni 15**

Neni 41 ndryshon si më poshtë:

3. “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:
të gjitha njësitë ekonomike, të cilat, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:
 - i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
 - ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
 - iii. ka, mesatarisht, të paktën 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël.Të gjitha njësitë ekonomike të cilat plotësojnë të paktën një nga kushtet e përcaktuara në pikat i-iii, duhet të realizojnë shërbimin e rishikimit të pasqyrave financiare në përputhje me standardet.
4. Të gjitha njësitë ekonomike të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare si njësi ekonomike të vogla dhe të mesme mund të kryejnë auditimin nëpërmjet audituesve ligjorë apo shoqërive audituese apo bashkimit të përkohshëm të tyre.. Ky bashkim duhet të realizohet për një periudhë minimale 3 vjetore, duke filluar nga data e angazhimit të parë. Në rast së përgjatë viteve pasuese nuk do të këtë aktivitetet në bazë të këtij bashkimi atëhëre palët do të jenë subjekt i sanksioneve neni 55.
5. Të gjitha njësitë ekonomike të klasifikuara të mëdha dhe NJEIP, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, detyrohen ta kryejnë auditimin nëpërmjet shoqërive audituese dhe/ose bashkimit të përkohshëm të audituesve ligjorë dhe/ose shoqërive të auditimit. Ky bashkim duhet të realizohet për një periudhë minimale 3 vjetore, duke filluar nga data e angazhimit të parë. Në rast së përgjatë viteve pasuese nuk do të këtë aktivitetet në bazë të këtij bashkimi atëhëre palët do të jenë subjekt i sanksioneve neni 55.

4. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 kreu VIII Shkeljet dhe Sanksionet

Opinion i përgjithshëm i IEKA në lidhje me shkeljet dhe sanksionet

Direktiva 2014/56/BE trajton edhe kushtet e lidhura me dënimet dhe sanksionet. Një përmbledhje e kuptimit tonë sa këto kërkesa vijnë :

1. **Hetimet dhe Sanksionet:** Neni 30 përcakton se Shtetet Anëtare duhet të kenë sisteme efektive për hetimet dhe sanksionet për të zbuluar, korrigjuar dhe parandaluar kryerjen e pamjaftueshme të auditimeve ligjore.
Këto sanksione përfshijnë masa administrative dhe mund të çojnë në tërheqjen e miratimit për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, veçanërisht nëse nuk përputhen me dispozitat e Direktivës ose me Rregulloren (BE) Nr. 537/2014.
2. **Fuqitë Sanksionuese:** Neni 30a i jep autoriteteve kompetente fuqinë për të vendosur disa sanksione, si:
 - Një njoftim për të ndaluar dhe për të mos përsëritur sjelljen.
 - Një deklaratë publike që tregon personin përgjegjës dhe natyrën e shkeljes.
 - Ndalime të përkohshme për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit nga kryerja e auditimeve për deri në tre vjet.
 - Sanksione administrative financiare për personat fizikë dhe juridikë.
3. **Konsiderimi i Shkeljeve të Mëparshme dhe Dënimeve Penale:** Kur përcaktohen sanksionet, autoritetet duhet të marrin parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë rëndësinë e shkeljes, shkallën e përgjegjësisë, shkeljet e mëparshme dhe fuqinë financiare të personit përgjegjës.
Neni 30 pika 2 parashikon që Shtetet anëtare mund të vendosin **të mos vendosin rregulla për sanksione administrative për shkeljet që tashmë janë subjekt i legjislacionit penal kombëtar**. Në këtë rast, ata do t'i komunikojnë Komisionit dispozitat përkatëse të legjislacionit penal.
4. **Publikimi i Sanksioneve:** Neni 30c kërkon që sanksionet e vendosura të publikohen në faqen zyrtare të autoriteteve kompetente pasi të jenë shteruar ose skaduar të gjitha të drejtat e apelit. Kjo përfshin natyrën e shkeljes dhe identitetin e personit ose entitetit të sanksionuar, me dispozita për publikimin anonim në raste të veçanta, si kur publikimi mund të rrezikojë hetimet e vazhdueshme penale.

Më tej ne mendojmë që parashikimet e

- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 7) Sjell ndryshime në Neni 24:** Heqja e së drejtës për të kryer shërbimin e auditimit ligjor për shoqëritë audituese dhe audituesit ligjorë
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 19) Sjell ndryshime në Neni 55:** Shkeljet dhe masat disiplinore
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 20) Sjell ndryshime në Neni 55:** Shkeljet dhe masat disiplinore
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 21) Sjell ndryshime në Neni 57/1:** E drejta e ankimit
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 22) Sjell shfaqimin e Neni 58:** Ushtrimi i profesionit të Audituesit ligjor dhe shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar

- i) tejkalojnë frymën e Direktivës 2014/56/BE dhe Rregullores (EU) Nr. 537/2014, pasi ky projekt-ligj vendos rregulla *shumë më strikte se ai i parashikuar nga Legjislacioni European*, të cilat mund të çojnë në heqjen e së drejtës për të kryer shërbimin e auditimit**

ligjor për shoqëritë audituese dhe audituesit ligjorë, dhe vendos sanksione që tejkalojnë të ardhurat mesatare vjetore të Audituesve Ligjorë dhe Shoqërive të Auditimit.

Bazuar në kuptimin tonë, Direktiva 2014/56/EU thekson rëndësinë e një sistemi efektiv hetimi dhe sanksionesh për të zbuluar, korrigjuar dhe parandaluar ekzekutimin e pamjaftueshëm të auditimit ligjor. Sanksionet e parashikuara duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese dhe në përcaktimin e llojit dhe nivelit të sanksioneve administrative, autoritetet kompetente në vend duhet të marrin parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë:

- Rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes.
- Shkallën e përgjegjësisë së personit përgjegjës.
- Forcën financiare të personit përgjegjës.
- Shumat e fitimeve të fituara ose humbjeve të shmangura nga personi përgjegjës.
- Nivelin e bashkëpunimit të personit përgjegjës me autoritetin kompetent.
- Shkeljet e mëparshme nga personi juridik ose natyror përgjegjës.

ii) Në të njëjtën frymë edhe Rregullorja 537/2014 përmban dispozita që kërkojnë që autoritetet kompetente të kenë fuqinë të ndërmarrin ose të imponojnë të paktën masat dhe sanksionet administrative për shkeljet e dispozitave të saj dhe të Direktivës 2014/56/EU.

Masa përfshijnë ndalimin e përkohshëm të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit nga kryerja e auditimeve ligjore dhe/ose nënshkrimi i raporteve të auditimit për një periudhë deri në tre vjet.

Po njësoj si Direktiva dhe rregullorja thekson që masat dhe sanksionet duhet të jenë proporcionale me shkeljet e bëra.

Pra në konkluzion Direktiva 2014/56/EU dhe Rregullorja 537/2014, vendosin një theks të rëndësishëm në parimin e proporcionalitetit të dënimeve dhe sanksioneve për audituesit ligjorë dhe shoqëriat e auditimit.

Kjo përfshin marrjen parasysh të faktorëve të ndryshëm për të siguruar që sanksionet janë të përshtatshme për rëndësinë e shkeljes dhe për të parandaluar abuzimet në të ardhmen përgjatë ushtrimit të profesionit të audituesit ligjor.

Ne vijim të sa më lart argumentuar lutemi gjeni propozimet e IEKA, në lidhje me nenet e sipërpërmendura.

Propozimi 15 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 7 i Projekt-Ligj Nr. /2024

Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 7) Sjell ndryshime në Neni 24: Heqja e së drejtës për të kryer shërbimin e auditimit ligjor për shoqëritë audituese dhe audituesit ligjorë

IEKA mendon që ky modifikim i paraqitur projekt-ligj i nenit 7 pikën 4, gërma a):

- bie në kundërshtim me legjislacionin penal sipas të cilit shkalla e dënimit përcaktohet në përfundim të procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e tij, (parimi i prezumimit të pafajësisë).
- është i përgjithshëm **dhe nuk kufizohet në kategorinë e auditimit ligjor të pasqyrave financiare nga audituesit**, duke rrezikuar aftësinë e profesionistëve për të siguruar për të ardhmen dhe mirëqënien e tyre.

Sa më sipër IEKA propozon ndryshimet vijuese në nenin 7 të projekt-ligjit.

ISHTË Quote Në nenin 24, pas pikës 3, shtohet pika 4, me përmbajtje si më poshtë vijon: “4. Për qëllime të pikës 3 të këtij neni, reputacioni i mirë i një audituesi ligjor ose shoqërie audituese mund të konsiderohet si i dëmtuar ndjeshëm, por pa u kufizuar, në situatat e mëposhtme: a) është vendosur një masë shtrënguese që përfshin heqjen ose kufizimin e lirisë gjatë procedimit penal për një vepër të kryer me dashje; b) është objekt i masës ndaluese që i ka ndaluar ushtrimin e profesionit të audituesit ligjor; c) është vendosur një sanksion disiplinor ose administrativ nga institucione të tjera Shqiptare ose të huaja për shkelje profesionale; ç) ka shkelur rëndë ose në mënyrë të përsëritur kodin e etikës, rregullat e moralit dhe të profesionit, rekomandimet e autoriteteve apo të ngjashme.”. Unquote	BEHET Quote Në nenin 24, pas pikës 3, shtohet pika 4, me përmbajtje si më poshtë vijon: “4. Për qëllime të pikës 3 të këtij neni, reputacioni i mirë i një audituesi ligjor ose shoqërie audituese mund të konsiderohet si i dëmtuar ndjeshëm, por pa u kufizuar, në situatat e mëposhtme: a) është <u>marre një vendim gjyqësor i formës së prerë</u> që përfshin heqjen ose kufizimin e lirisë gjatë procedimit penal për një vepër të kryer me dashje <u>në fushën e auditimit ligjor dhe për të cilin ekziston një masë ndalim për ushtrim të profesionit me vendim gjyqësor</u> ; b) është objekt i masës ndaluese që i ka ndaluar ushtrimin e profesionit të audituesit ligjor; c) është vendosur një sanksion disiplinor ose administrativ nga institucione të tjera Shqiptare ose të huaja për shkelje profesionale në mënyrë të rëndë dhe të përsëritur; ç) ka shkelur rëndë ose në mënyrë të përsëritur kodin e etikës, rregullat e moralit dhe të profesionit, rekomandimet e autoriteteve mbikqyrëse të profesionit <u>apo të autoriteteve të ndryshme mbikqyrëse të tregut</u> . Unquote
---	--

Propozimi 16 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 19, 20,21,22 i Projekt-Ligj Nr. /2024

- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 19) Sjell ndryshime në Neni 55:** Shkeljet dhe masat disiplinore
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 20) Sjell ndryshime në Neni 55:** Shkeljet dhe masat disiplinore
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 21) Sjell ndryshime në Neni 57/1:** E drejta e ankimit
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 22) Sjell shfiqizimin e Neni 58:** Ushtrimi i profesionit të Audituesit ligjor dhe shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar

Sa më sipër argumentuar, dhe në përputhje me rekomandimet tona ne seksionin e Financimi i Bordit të Mbikqyrjes, neni 55 i propozuar për ndryshim nga ky projekt-ligji

- a) nuk merr në konsideratë shkallën e shkeljes dhe të shpeshhtësisë së ndodhjes së shkeljes;
- b) mbart disproporcion në lidhje me masën e sanksioneve që vendosen;
- c) krijon presumin që sanksionet llogariten sipas shkeljeve të veçanta pika 3,4 dhe 5 dhe që së bashku ose veçmas krijojnë edhe kushtet për sanksionim shtesë në ërpthje me pikën 2;

- d) nuk identifikon në detaje llojet e shkeljeve në përputhje me Direktiven dhe Rregulloren në zbatim të saj, dhe shkakton konfuzion në lidhje me identifikimin e shkeljeve;
- e) penalteti i parashikuar, në formën e gjobës, varion bazuar në kufij pika 2 gërma c) , pika 3 dhe pika 4, duke i dhënë mundësi BMP që aplikim jo mbi baza të qëndrueshme për të njëjtën lloj shkeljeje të realizuar në të njëjtat kushte,
- f) penalteti i parashikuar, në forëm e gjobës, pika 2 gërma c) , pika 3 dhe pika 4, llogaritet bazuar në qarkullimin vjetor të audituesit ligjor osë shoqërisë së auditimit, pavarësisht shkeljes specifike, duke rritur sërish kostot e shërbimit në mënyrë joproporcionale;

me tej ne vlerësojmë që

- këto masa gjobash janë një tentativë për të rritur masën e financimit nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të Bordit të Mbikqyrjes Publike.
- tentativa për publikim pa përfshirë një seksion të qartë që ti dedikohet krijimit të një procesi transparent të ankimit dhe me afate të zbatueshme nga palët pjesëmarrëse, krijon kushtet për pabarazi në trajtimin e anëtarëve subjekt i propozimeve për shkelje dhe sanksione;
- nuk është i plotë në përputhje me kërkesat e direktivës dhe rregullorës, përmes kësaj që projektligji nuk parashikimin sanksionimin e organeve drejtuese të shoqërive NjENP të cilat nuk respektojnë kërkesat e ligjit të auditimit;

Si rrjedhojë ne rekomandojmë që i gjithë seksioni Shkeljet dhe Sanksionet duhet të ripunohet, ku një propozim i yne është vendosur në kolonën e tretë, me qëllim që të sigurojë parimet sa më sipër, dhe të vendosi para përgjegjësisë ligjore administrative dhe penale, sipas rastit, audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që veprojnë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Rekomandimet për ndryshimet e projekt-ligjit paraqiten në kolonën 2 të tabelës këtu:

KOLONA 1	KOLONA 2	KOLONA 3
ISHTË Neni 19 Në nenin 55, nga pika 1 deri në pikën 8 bëhen ndryshimet si më poshtë: “1.BMP është përgjegjës për krijimin dhe zbatimin e një sistemi efektiv të investigimeve dhe sanksioneve, me qëllim zbulimin, korrigjimin dhe parandalimin e mangësive gjatë ushtrimit të veprimtarisë së auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.”. “2. Në rast të moszbatimit të dispozitave të këtij ligji, në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer në lidhje me kontrollin e sigurimit të cilësisë, BMP ka të drejtë të marrë ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese një ose disa nga masat sanksionuese të mëposhtme: a) vërejtje, nëpërmjet të cilit, personi fizik ose personi juridik përgjegjës për shkeljen, i kërkohej të ndërprejë shkeljen dhe të kufizohet nga përsëritja e kësaj shkeljeje në të ardhmen; b) vërejtje me shënim në regjistrin publik, i cili tregon personin përgjegjës dhe natyrën e shkeljes; c) dënim me gjobë në masën nga 0,5% deri në 3% të qarkullimit vjetor të periudhës raportuese paraardhëse;	BEHET KORRIGJIM I VERSIONIT NË PROJEKT-LIGJ Neni 19 Në nenin 55, nga pika 1 deri në pikën 8 bëhen ndryshimet si më poshtë: “1.BMP është përgjegjës për krijimin dhe zbatimin e një sistemi efektiv të investigimeve dhe sanksioneve, me qëllim zbulimin, korrigjimin dhe parandalimin e mangësive gjatë ushtrimit të veprimtarisë së auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.”. 2. Në rast të moszbatimit të dispozitave të këtij ligji, në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer në lidhje me kontrollin e sigurimit të cilësisë, BMP ka të drejtë të marrë ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese një ose disa nga masat sanksionuese të mëposhtme: a) Një paralajmërim, që imponon ndaj personit fizik ose juridik përgjegjës për shkeljen të ndërprejë sjelljen dhe të përmbahet nga përsëritja e saj; b) Një deklaratë në të cilën tregohet se raporti i auditimit nuk plotëson kërkesat e nenit 37 Standartet dhe nenit 43/1 Raporti i Auditimit; c) Qortim, që përbëhet nga një deklaratë publike e qortimit, e cila tregon personin përgjegjës dhe natyrën e shkeljes; ç) dënim me gjobë nga një mijë deri në njëqind mijë Lekë; d) Pezullim nga Regjistrin, për një periudhë	BEHET NDRYSHIM TERËSOR NË PËRPUTHJE ME DIREKTIVËN DHE RREGULLOREN Neni 55 – Shkeljet dhe Sanksionet 1. Bordi i Mbikqyrjes Publike, kur konstaton parregullsi në kryerjen e aktivitetit të auditimit ligjor, mund të aplikojë sanksionet e mëposhtme: a) Një paralajmërim, që imponon ndaj personit fizik ose juridik përgjegjës për shkeljen të ndërprejë sjelljen dhe të përmbahet nga përsëritja e saj; b) Një deklaratë në të cilën tregohet se raporti i auditimit nuk plotëson kërkesat e nenit 37 Standardet e Auditimit, Neni 36 Rregullat e Auditimit dhe nenit 43/1 Raporti i Auditimit; c) Qortim, që përbëhet nga një deklaratë publike e qortimit, e cila tregon personin përgjegjës dhe natyrën e shkeljes; d) Sanksion administrativ në formën e gjobës nga një mijë deri në njëqind mijë Lekë; e) Pezullim nga Regjistrin, për një periudhë jo më të gjatë se tre vjet, për subjektin që është përgjegjës për parregullsitë e lidhura me detyrën e auditimit ligjor; f) Revokim i një ose më shumë detyrave të auditimit ligjor; g) Ndalim për Audituesin ligjor ose për Shoqërinë e Auditimit të pranojnë detyra të reja të auditimit ligjor për një periudhë jo më të gjatë se tre vjet; h) Fshirje nga Regjistrin Publik e ortakut të angazhimit ose e shoqërisë së auditimit. 2. Bordi i Mbikqyrjes Publike mund të aplikojë sanksionet e përcaktuara në paragrafin 1 në rastet e mëposhtme: a) Mosplotësim i detyrimeve të edukimit të vijueshëm profesional; b) Mosrespektim i detyrimeve për komunikimin e informacioneve të përcaktuara dhe miratuara nga Bordi i Mbikqyrjes dhe Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë dhe i Shoqërive e Auditimit, si

~~e) pezullim i përkohshëm, nga një deri në tre vjet, që ndalon audituesin ligjor, shoqërinë audituese ose partnerin kryesor të auditimit të kryejë auditim ligjor dhe/ose të nënshkruajë raporte të auditimit ligjor;~~
~~heqja e të drejtës për ushtrimin e profesionit, çregjistrimi i audituesit ligjor nga regjistri publik dhe humbja e të drejtës së regjistrimit.”.~~

~~“3. Do të zbatohet sanksioni 0,5 deri në 1,5%, të qarkullimit vjetor të periudhës raportuese paraardhëse, në rastet kur konstatohet se nuk janë zbatuar një ose disa nga pikat e mëposhtme:~~

- ~~a) nuk zbaton kërkesat e nenit 44 pika 1 dhe/ose 4;~~
~~b) nuk kryen njoftimin në përputhje me nenin 30 të këtij ligji;~~
~~c) nuk zbaton kërkesat e nenit 25 të këtij ligji dhe të rregullores për edukimin e vazhdueshëm profesional;~~
~~d) nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenin 45 të këtij ligji;~~
~~e) nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në kuadër të kontrollit të sigurimit të cilësisë.”.~~

~~“4. Do të zbatohet sanksioni 1,5% deri në 3%, të qarkullimit vjetor të periudhës raportuese paraardhëse, në rastet kur konstatohet se nuk janë zbatuar një ose disa nga pikat e mëposhtme:~~

- ~~a) nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenin 42 të këtij ligji;~~
~~b) nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në seksionin IV të kreut IV të këtij ligji;~~
~~c) nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat në lidhje me rishikimin e kontrollit të cilësisë së angazhimit;~~
~~d) në rastet kur personat që kanë kaluar testimet e aftësive profesionale, ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor pa qenë të regjistruar më parë në Regjistrin Publik të Audituesve Ligjorë;~~
~~e) nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji.”.~~

~~“5. Masa sanksionuese të parashikuara në germenin (d) të pikës (1), do të zbatohet në rastet kur, në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer në lidhje me kontrollin e sigurimit të cilësisë, konstatohet një ose disa prej shkeljeve të mëposhtme:~~

- ~~a) rezultatet e auditimit ligjor të~~

~~jo më të gjatë se tre vjet, për subjektin që është përgjegjës për parregullsitë e lidhura me detyrën e auditimit ligjor;~~

- ~~e) Revokim i një ose më shumë detyrave të auditimit ligjor;~~
~~f) Ndalim për Audituesin ligjor ose për Shoqërinë audituese të pranojnë angazhime të reja të auditimit ligjor për një periudhë jo më të gjatë se tre vjet;~~
~~g) Fshirje nga Regjistri Publik i Ortakut të Angazhimit dhe audituesit ligjor.~~

3. Bordi i Mbikqyrjes Publike mund të aplikojë sanksionet e përcaktuara në paragrafin 1 në rastet e mëposhtme:

- a) Mosplotësim i detyrimit të edukimit të vijueshëm profesional;
- b) Mosrespektim i detyrimeve për komunikimin e informacioneve të përcaktuara në **nenin 30 dhe neni 44 pika 1 dhe 4, si dhe të dhënave** të kërkuara të detyrave të kryera prej tyre dhe të ardhurave dhe shpërblimeve përkatëse në përputhje me **nenin 42**.

c) Në rastet e përcaktuara në këtë paragraf, sanksioni administrativ në formën e gjobës aplikohet në masën nga një mijë Lekë deri në dy mijë Lekë.

4. Bordi i Mbikqyrjes Publike mund të aplikojë sanksionet e përcaktuara në paragrafin 1 në rastet e mëposhtme:

- a) Mosrespektim i detyrimeve të **përcaktuara seksionin IV, Kreu IV.**
- b) Mosrespektim i detyrimeve të përcaktuara **neni 38 Sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë.**

c) Në rastet e përcaktuara në këtë paragraf, sanksioni administrativ në formën e gjobës aplikohet në masën nga një dhjetë mijë Lekë deri në pesëqind mijë Lekë;

5. Bordi i Mbikqyrjes Publike mund të aplikojë sanksionet e përcaktuara në paragrafin 1 në rastet e mëposhtme:

- a) në përfundim të kontrollit pasues vlerësohet se audituesi ligjor apo shoqëria audituese nuk janë zbatuar afatet e vendosura nga BMP dhe rekomandimet e dhëna në raportin përfundimtar të

dhe të dhënave të kërkuara për identifikimin e saktë të Audituesit ligjor ose të firmës së auditimit ligjor, të detyrave të kryera prej tyre dhe të ardhurave dhe shpërblimeve përkatëse.

c) Në rastet e përcaktuara në këtë paragraf, sanksioni administrativ në formën e gjobës aplikohet në masën nga një mijë Lekë deri në dy mijë Lekë.

3. Bordi i Mbikqyrjes Publike vendos fshirjen nga Regjistri të audituesve ligjorë, të shoqërisë së auditimit ose të ortakut të angazhimit kur nuk respektojnë masat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2.

4. Audituesi ligjor dhe shoqëria e auditimit e fshirë sipas këtij neni mund të ri-regjistrohet, me kërkesë, me kusht që të kenë kaluar të paktën gjashtë vjet nga masa e fshirjes.

5. Bordi i Mbikqyrjes Publike publikon në faqen zyrtare të internetit çdo sanksion administrativ të dhënë për shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë informacionet që lidhen me llojin dhe natyrën e shkeljes dhe identitetin e personit fizik ose juridik ndaj të cilit është dhënë sanksioni.

6. Në rast se sanksionet janë objekt ankimi, në faqen e internetit të Bordit dhe Organizatës profesionale publikohen informacionet që lidhen me gjendjen dhe rezultatin e ankimit.

7. Bordi i Mbikqyrjes Publike mund të publikojë sanksionet në formë anonime në situatat e mëposhtme:

a) Nëse publikimi i të dhënave personale që lidhen me një person fizik është i tepërt në krahasim me llojin e shkeljes;

b) Nëse publikimi rrezikon stabilitetin e tregjeve financiare ose një hetim penal në vazhdim;

c) Nëse publikimi shkakton dëm të tepërt institucioneve ose personave të përfshirë.

8. Sanksionet e dhëna sipas këtij neni publikohen në faqen zyrtare të internetit për një periudhë minimale prej pesë vjetësh pas shterimit të të gjitha mjeteve të kontestimit ose pas përfundimit të afateve të përcaktuara. Bordi i Mbikqyrjes Publike, duke marrë parasysh natyrën e shkeljes dhe interesat e përfshira, mund të përcaktojë mënyra të tjera për të bërë publik vendimin.

9. Bordi i Mbikqyrjes Publike, kur konstaton mosrespektimin ose zbatimin e pamjaftueshëm të një sistemi të brendshëm raportimi, mund të marrë parasysh rëndësinë e shkeljes dhe:

a) Të aplikojë ndaj firmës së auditimit ligjor një sanksion administrativ në formën e gjobës nga dhjetë mijë Lekë deri në pesëqind mijë Lekë;

b) Të urdhërojë personin juridik përgjegjës për shkeljen që të ndërpresë sjelljen dhe të përmbahet nga përsëritja e saj.

Neni 55/1- Pezullim Parandalues

1. Bordi i Mbikqyrjes Publike mund të vendosë, në lidhje me rëndësinë e faktit, një pezullim parandalues të Audituesit Ligjor për një periudhë jo më të gjatë se 1 vit.

2. Pezullimi parandalues nga Regjistri gjithsesi vendoset në rastet e aplikimit nga ana e Autoritetit Gjyqësor të masave paraprake personale ose të konfirmimit të arrestimit ose ndalimit, ose të dënimeve që lidhen me zhvillimin e auditimit, edhe nëse nuk janë përfundimtare, që sjellin aplikimin e një mase sigurie të paraburgimit ose të lirit me kusht.

3. Kur pezullimi është vendosur në varësi të procedurës penale dhe kjo përfundon me një vendim të pafajësisë ose të shpalljes së pafajësisë që ka kaluar në formën e prerë sepse fakti nuk ekziston ose sepse fakti i akuzuar nuk është kryer, pezullimi revokohet me efekt që nga data e shpalljes së vendimit.

Neni 55/2 - Pezullimi për mospagim

6. Në rastin e mospagimit të kontributit vjetor sipas nenit --, paragrafi --- pas kalimit të tre muajve nga afati i përcaktuar, Bordi i

paraqitura në raportin e auditimit nuk mbështeten në procedurat e punës dhe evidencën e auditimit, në zbatim të kërkesave përkatëse të standardeve ndërkombëtare të auditimit;

b) janë kryer në më shumë se 1/3 e dosjeve të angazhimeve të auditimit ligjor, shkeljet e sanksionueshme në pikën (3) germa (a) deri (d);

c) në përfundim të kontrollit pasues vlerësohet se audituesi ligjor apo shoqëria audituese nuk janë zbatuar afatet e vendosura nga BMP dhe rekomandimet e dhëna në raportin përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë.

ç) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e qëllimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë nga BMP;

d) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e procedurës të investigimit nga BMP.”.

~~“6. Masat sanksionuese të përmendura në këtë nen do të detajohen në rregulloren dhe procedurat për investigimin dhe marrjen e masave sanksionuese të miratuar nga BMP.”.~~

~~“7. Afati i përfundimit të procedurave të investigimit është deri në 6 muaj nga data e vendimit për fillimin e procedurës të investigimit. Ky afat mund të zgjatet, me vendim të BMP, në rast se kërkohen investigime të mëtejshme, që kanë të bëjnë me prova, të dhëna shtesë dhe ekspertizë të specializuar për shqyrtimin e rastit.”.~~

kontrollit të sigurimit të cilësisë.

b) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e qëllimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë nga BMP;

c) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e procedurës të investigimit nga BMP.

“6. Procedura e Vendosijs se Sanksioneve

1. Sanksionet administrative të parashikuara në këtë nen vendosen nga Bordi i Mbikqyrjes Publike bazuar në një vendim të arsyetuar, pas njoftimit të shkëlqjeve ndaj të interesuarve.

Njoftimi i shkëlqjeve duhet të kryhet brenda njëqind e tetëdhjetë ditësh nga zbulimi ose brenda treqind e gjashtëdhjetë ditësh nëse i interesuari banon ose ka selinë jashtë vendit, dhe pasi të jenë vlerësuar komentet e paraqitura nga audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit në kthim përgjigjen e njoftimit i cili realizohet brenda tridhjetë ditëve nga njoftimi paraprak i tyre.

2. Procedura e vendosjes së sanksioneve siguron pjesmarrjen përgjatë procesit të të gjitha palëve, njohjen e akteve, dokumentimin dhe dallimi midis funksioneve investiguese dhe vendimmarrëse.

3.1 Lloji dhe masa e sanksionit ose e masës administrative që duhet të merret përcaktohen, në veçanti, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë, nëse është e nevojshme:

- ashpërsinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes;
- shkallën e përgjegjësisë së personit që ka kryer shkeljen;
- qëndrueshmërinë financiare të personit përgjegjës;
- shumën e fitimeve të përfituara ose të humbjeve të shmangura nga personi përgjegjës, nëse mund të përcaktohen;
- nivelin e bashkëpunimit të personit përgjegjës me autoritetin mbikëqyrës;
- shkeljet e mëparshme të personit fizik ose juridik përgjegjës.

Mbikqyrjes Publike bazuar në propozimin e organizatës profesionale të audituesve ligjore dhe i shoqërive të auditimit cakton një afat, jo më të gjatë se gjashtëdhjetë ditë të tjera, për të kryer pagesën. Pas përfundimit të këtij afati të mëtejshëm pa kryer pagesën, Auditues ose shoqëria e auditimit pezullohen nga Regjistri.

Vendimi i pezullimit i komunikohet me e-mail të deklaruar në Regjistër nga subjekti i interesuar ose në forma të tjera të përcaktuara nga legjislacioni.

Në rast se komunikimi individual është veçanërisht i rëndë, masa e pezullimit mund të publikohet, në formë të plotë ose të përmbledhur.

7. Bordi i Mbikqyrjes Publike vendos heqjen e masës së pezullimit kur i regjistruari, bazuar në informacionin e organizatës profesionale të audituesve ligjore dhe i shoqërive të auditimit dëshmon se ka paguar plotësisht kontributet e detyruara, të ngarkuara me interesat ligjore dhe shpenzimet e mundshme të kryera për t'i mbledhur.

8. Pas kalimit të 6 muajve të mëtejshëm nga data e masës që vendos pezullimin, nëse nuk janë paguar ende kontributet e prapambetura, Bordi i Mbikqyrjes Publike, pas njoftimit, vepron për fshirjen nga Regjistri sipas modaliteteve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 55/3 - Procedura e vendosjes së sanksioneve

1. Sanksionet administrative të parashikuara në këtë nen vendosen nga Bordi i Mbikqyrjes Publike bazuar në një vendim të arsyetuar, pas njoftimit të shkëlqjeve ndaj të interesuarve. Njoftimi i shkëlqjeve duhet të kryhet brenda njëqind e tetëdhjetë ditësh nga zbulimi ose brenda treqind e gjashtëdhjetë ditësh nëse i interesuari banon ose ka selinë jashtë vendit, dhe pasi të jenë vlerësuar komentet e paraqitura nga audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit në kthim përgjigjen e njoftimit i cili realizohet brenda tridhjetë ditëve nga njoftimi paraprak i tyre.

2. Procedura e vendosjes së sanksioneve siguron pjesmarrjen përgjatë procesit të të gjitha palëve, njohjen e akteve, dokumentimin dhe dallimi midis funksioneve investiguese dhe funksioneve vendimmarrëse.

3.1 Lloji dhe masa e sanksionit ose e masës administrative që duhet të merret përcaktohen, në veçanti, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë, nëse është e nevojshme:

- ashpërsinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes;
 - shkallën e përgjegjësisë së personit që ka kryer shkeljen;
 - qëndrueshmërinë financiare të personit përgjegjës;
 - shumën e fitimeve të përfituara ose të humbjeve të shmangura nga personi përgjegjës, nëse mund të përcaktohen;
 - nivelin e bashkëpunimit të personit përgjegjës me autoritetin mbikëqyrës;
 - shkeljet e mëparshme të personit fizik ose juridik përgjegjës.
- 3.2 Bordi i Mbikqyrjes Publike përcakton me rregullore fazat dhe mënyrat e zhvillimit të procedurës e vendosjes së sanksioneve, duke respektuar, ndër të tjera, garancitë për të regjistruarit në Regjistër.
- 3.3 Shkelja disiplinore parashkruhet brenda pesë viteve nga ngjarja që mund të çojë në hapjen e procedurës e vendosjes së sanksioneve.
- 3.4 Në rastin kur masat e parashikuara në nenin 55 përfshijnë një sanksion administrativ financiar, i njëjti sanksion reduktohet në gjysmën e vlerës nëse paguhet brenda tridhjetë ditësh nga marrja e njoftimit.

4. Kundër vendimit të aplikimit të sanksioneve të parashikuara në nenin 55 dhe fraksionet e tij, lejohet apelimi në Gjykatën Administrative ku ka selinë shoqëria e auditimit ose Audituesi ligjor që ka kryer shkeljen, ose, në rastet kur ky kriter nuk është i zbatueshëm, të vendit ku është kryer shkelja.

~~"8. Masat sanksionuese me gjobë të vëna nga BMP përbëjnë titull ekzekutiv dhe ekzekutohen sipas nenit 510 të Kodit të Procedurave Civile."~~

Neni 20

Pas nenit 55, shtohet neni 55/1 dhe neni 55/2 me përmbajtje si më poshtë:

Neni 55/1

Publikimi i masave sanksionuese

1. Përveç publikimit në Regjistrin Publik, masat sanksionuese do të publikohen gjithashtu edhe në faqen zyrtare të BMP, shoqëruar me informacion mbi llojin dhe natyrën e shkeljes dhe identitetin e individit ose personit juridik për të cilin është vendosur sanksioni, pasi të gjitha të drejtat e apelimit, të parashikuara në nenin 57/1 të këtij ligji, janë shteruar ose me përfundimin e afatit të ankimit. Akti sanksionues duhet të përmbajë edhe dispozitat për mënyrën e publikimit.

2. BMP dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë, referuar sanksioneve që kanë qenë objekt ankimi në përputhje me nenin 57/1 të këtij ligji, publikojnë, sa më shpejt dhe në mënyrë sa më të arsyeshme që të jetë e mundur, informacione në lidhje me statusin dhe rezultatin e çdo ankimi.

3. BMP dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë mund

3.2 Bordi i Mbikqyrjes Publike përcakton me rregullore fazat dhe mënyrat e zhvillimit të procedurës e vendosjes së sanksioneve, duke respektuar, ndër të tjera, të drejtat për të regjistruarit në Regjistrin.

3.3 Shkelja disiplinore parashkruhet brenda pesë viteve nga ngjarja që mund të çojë në hapjen e procedurës e vendosjes së sanksioneve.

3.4 Në rastin kur masat e parashikuara në nenin 55 përfshijnë një sanksion administrativ financiar, i njëjti sanksion reduktohet në gjysmën e vlerës nëse paguhet brenda tridhjetë ditësh nga marrja e njoftimit.

7. Në rastin e mospagimit të detyrimeve për sanksionet në përputhje të këtij ligji, pas kalimit të tre muajve nga afati i përcaktuar, Bordi i Mbikqyrjes Publike cakton një afat, jo më të gjatë se gjashtëdhjetë ditë të tjera, për të kryer pagesën.

Pas përfundimit të këtij afati të mëtejshëm pa kryer pagesën, Audituesi Ligjor ose shoqëria e auditimit pezullohet nga Regjistrin.

Neni 20

Pas nenit 55, shtohet neni 55/1 dhe neni 55/2 me përmbajtje si më poshtë:

Neni 55/1

Publikimi i masave sanksionuese

1. Përveç publikimit në Regjistrin Publik, masat sanksionuese do të publikohen gjithashtu në faqen zyrtare të BMP dhe në regjistrin publik, shoqëruar me informacion mbi llojin dhe natyrën e shkeljes dhe identitetin e individit ose personit juridik për të cilin është vendosur sanksioni, pasi të gjitha të drejtat e apelimit, të parashikuara në nenin 57/1 të këtij ligji, janë shteruar ose me përfundimin e afatit të ankimit.

Akti sanksionues duhet të përmbajë edhe dispozitat për mënyrën e publikimit.

Bordi i Mbikqyrjes Publike informon Organizatën profesionale të Audituesve Ligjorë dhe i Shoqërive të Auditimit, për vendimet e parashikuara në këtë ligj, për qëllime të regjistrimit të tyre në Regjistrin

2. BMP dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë, referuar sanksioneve që kanë qenë objekt ankimi në përputhje me nenin 57/1 të këtij ligji, publikojnë, sa më shpejt dhe në mënyrë sa më të arsyeshme që të jetë e mundur, informacione në lidhje me statusin dhe rezultatin e çdo ankimi.

3. BMP dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë mund të publikojnë

Apelimi duhet t'i njoftohet Bordit të Mbikqyrjes Publike brenda tridhjetë ditësh nga komunikimi dhe duhet të depozitohet në kancelarinë e Gjykatës brenda tridhjetë ditësh nga njoftimi.

5. Apelimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Gjykata nëse ekzistojnë arsye të forta, mund të vendosë pezullimin me vendim.

6. Kopja e vendimet dërgohet të Gjykatës pranë Bordit të Mbikqyrjes Publike për qëllime të publikimit në faqen e internetit të Bordit.

Neni 55/3- Sanksioni për shkeljet që evidentohen gjatë auditimit të Njësisë Ekonomike me Interes Publik

1.1 Kur Bordi i Mbikqyrjes Publike konstaton shkeljet të dispozitave të këtij ligji në vecanti Neni 32 Etika profesionale dhe papajtueshmëritë dhe 32/1 Skepticizmi profesional, neni 35 Pavarësia dhe objektiviteti, neni 33 Konflikti i Interesit, neni 37 Standardet e Auditimit, neni 36 Rregullat e Auditimit dhe nenit 43/1 Raporti i Auditimit apo rregulloretë të miratuara mund të aplikojë sanksionet vijuese:

a) Sanksion administrativ nga 10,000 Lekë deri në 500,000 Lekë kundër Audituesit ligjor, shoqërisë së Auditimit ligjor dhe personit përgjegjës për detyrën; për shkeljen e ndalimeve të ne neni 35 Pavarësia dhe objektiviteti, neni 33 Konflikti i Interesit të këtij ligji aplikohet një sanksion administrativ nga 100,000 Lekë deri në 500,000 Lekë.

b) Aplikon revokimin e një ose më shumë detyrave të Auditimit ligjor në lidhje me Njësitë me Interes Publik.

c) Ndalimin e Audituesit ligjor ose shoqërisë së Auditimit ligjor për të pranuar detyra të reja të Auditimit ligjor në lidhje Njësitë me Interes Publik për një periudhë jo më të gjatë se tre vjet.

d) Pezullimin nga Regjistrin për një periudhë jo më të gjatë se tre vjet të Audituesit ligjor, shoqërisë së Auditimit ligjor ose personit përgjegjës për detyrën në të cilat vërehen parregullësi.

e) Fshirjen nga Regjistrin e Audituesit ligjor, shoqërisë së Auditimit ligjor ose personit përgjegjës për detyrën në të cilat vërehen parregullësi.

1.2 Bordi i Mbikqyrjes Publike informon Organizatën profesionale të Audituesve Ligjorë dhe i Shoqërive të Auditimit, për vendimet e parashikuara në paragrafin, për qëllime të regjistrimit të tyre në Regjistrin.

1.3 Kur shkeljet e parashikuara nën paragrafin 1 janë të karakterizuara nga një mungesë e vogël ose rreziku i ulët, Bordi i Mbikqyrjes Publike mund të, që si alternativë për sanksionet e parashikuara në të njëjtin paragraf:

a) Publikojë një deklaratë që tregon përgjegjësinë për shkeljen dhe natyrën e saj; ose

b) Fshin shkeljen, duke rekomanduar masat për tu marrë, kushtin e mospërsëritjes dhe të afatit për t'i përmbushur masat e propozuara.

1.4 Për moszbatimin brenda afatit të caktuar të urdhrave të parashikuar nënparagrafin 1.2, Bordi i Mbikqyrjes Publike aplikon sanksionin administrativ ndaj drejtuesve të Organizatës profesionale të Audituesve Ligjorë dhe i Shoqërive të Auditimit të parashikuar për shkeljen e evidentuar në vendimin e Bordit për regjistrimin në regjistrin publik.

1.5 Kur parregullësitë e konstatuara kanë shkaktuar lëshimin e një raporti të Auditimit që nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në neni 35 Pavarësia dhe objektiviteti, neni 33 Konflikti i Interesit të këtij ligji, Bordi i Mbikqyrjes Publike, në vendimin për aplikimin e sanksionit të parashikuar për shkeljen shpall dhe faktin që raporti i Auditimit nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në neni 36 Rregullat e Auditimit dhe nenit 43/1 Raporti i Auditimit të këtij ligji.

1.6 Kur parregullësitë i referohen kërkesat e përcaktuara në nenin 38 Sistemet e Dhënies së Sigurisë për Cilësinë dhe Neni 45 Raporti për

të publikojnë sanksionet e vendosura në mënyrë anonime dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar, në cilëndo nga rrethanat e mëposhtme:

- në rastet kur sanksioni është vendosur ndaj një individi dhe publikimi i të dhënave personale rezultojnë të jetë jo proporcional nga një vlerësim paraprak i detyrueshëm i proporcionalitetit të këtij publikimi;
- kur publikimi vë në rrezik stabilitetin e tregjeve financiare ose procesin hetimor në vazhdim;
- kur publikimi shkakton dëme jo proporcionale (më të mëdha se shkelja) për institucionet ose individët e përfshirë.

4. BMP duhet të sigurojë që çdo publikim në përputhje me pikën (1) të këtij neni, të ketë kohëzgjatje të arsyeshme dhe të ruhet në faqen e tyre zyrtare të internetit për të paktën pesë vite, pasi të jenë shteruar ose të kenë kaluar të gjitha të drejtat apo afatet e ankimit të parashikuara në nenin 57/1 të këtij ligji.

5. BMP publikon në faqen e tij zyrtare sanksionet administrative të dhëna sipas nenit 55/2, të cilat do të ruhen në këtë faqe për një periudhë 1 vjeçare që nga data e publikimit.

6. Publikimi i sanksioneve, ~~masave disiplinore, dhe i çdo deklarate publike~~ duhet të bëhet duke respektuar të drejtat themelore, në veçanti, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 55/2

Përgjegjësia administrative për strukturat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë

1. Anëtarët e organeve drejtuese të organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe anëtarët e tjerë të zgjedhur që mbajnë pozicione në strukturat drejtuese të tij janë përgjegjës për shkeljet administrative ose disiplinore të kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. BMP ka të drejtë të vendosë sanksionet e mëposhtme administrative:

- vërejtje me shkrim;
- ~~gjobë administrative që varion nga 1 deri në 10 paga mesatare kombëtare bruto;~~
- ~~pezullim i përkohshëm nga detyra për një periudhë nga 6 muaj deri në një vit. Në rast pezullimi të drejtorit ekzekutiv të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, emërohet një drejtor i përkohshëm në përputhje me statutin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë.~~

sanksionet e vendosura në mënyrë anonime dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar, në cilëndo nga rrethanat e mëposhtme:

- në rastet kur sanksioni është vendosur ndaj një individi dhe publikimi i të dhënave personale rezultojnë të jetë jo proporcional nga një vlerësim paraprak i detyrueshëm i proporcionalitetit të këtij publikimi;
 - kur publikimi vë në rrezik stabilitetin e tregjeve financiare ose procesin hetimor në vazhdim;
 - kur publikimi shkakton dëme jo proporcionale (më të mëdha se shkelja) për institucionet ose individët e përfshirë.
4. BMP duhet të sigurojë që çdo publikim në përputhje me pikën (1) të këtij neni, të ketë kohëzgjatje të arsyeshme dhe të ruhet në faqen e tyre zyrtare të internetit për të paktën pesë vite, pasi të jenë shteruar ose të kenë kaluar të gjitha të drejtat apo afatet e ankimit të parashikuara në nenin 57/1 të këtij ligji.

5. BMP publikon në faqen e tij zyrtare sanksionet administrative të dhëna sipas nenit 55/2, të cilat do të ruhen në këtë faqe për një periudhë 1 vjeçare që nga data e publikimit.

6. Publikimi i sanksioneve duhet të bëhet duke respektuar të drejtat themelore, në veçanti, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 55/2

Përgjegjësia administrative për strukturat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë

1. Anëtarët e organeve drejtuese të organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe anëtarët e tjerë të zgjedhur që mbajnë pozicione në strukturat drejtuese të tij janë përgjegjës për shkeljet administrative ose disiplinore të kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tyre që lidhen me veprimtarnë e përditësimin të dhenave të Regjistrat publik me informacionin mbi sanksionet.

2. BMP ka të drejtë të rekomandojë sanksionet e mëposhtme administrative:

- gjobë administrative që varion nga pesë mijë Lekë deri në njëzet e pesë mijë Lekë.

transparencën të këtij ligji, Bordi i Mbikqyrjes Publike, aplikon sanksionit e parashikuar në pikën 1.1 gërma a) dhe pikat 1.3 dhe 1.4.

1.7 Pa llogaritur zbatimin e sanksioneve të parashikuara në paragrafin 1, Bordi i Mbikqyrjes Publike, për moszbatimin e dispozitave të nenit __ (pavarësia) aplikon sanksionin administrativ nga 10,000 Lekë deri në 500,000 Lekë kundër anëtarëve të organeve të drejtuese të shoqërive të Auditimit ligjor kur moszbatimi është rezultat i shkeljes së detyrave të tyre ose të organeve të cilës së përkasin dhe kur përmbushen një ose të dyja kushtet e mëposhtme:

a) Veprimtaria ka ndikuar pavarësinë dhe cilësinë e Auditimit ligjor të shoqërisë së Auditimit;

b) Veprimtaria ka kontribuar në moszbatimin të detyrave të shoqërisë sipas dispozitave të neni 35 Pavarësia dhe objektiviteti), neni 33 Konflikti i Interesit të këtij ligji dhe të standardeve që lidhen të.

1.8 Me vendim për aplikimin e sanksionit, në bazë të rëndësisë së shkeljes së konstatuar, Bordi i Mbikqyrjes Publike mund të aplikojë sanksionin administrativ të përkohshëm të ndalimit, për një periudhë jo më të gjatë se tre vjet, nga ushtrimi i funksioneve të shoqëritë e Auditimit ligjor.

1.9. Kur Bordi i Mbikqyrjes Publike konstaton moszbatimin e detyrave, në funksion të zbatimit të detyrimeve të këtij ligji që janë të aplikueshme për njësitë ekonomike, nga organet drejtuese së një Njësie Ekonomike me interesit publik, të cilat nuk vënë në dispozicion të audituesit ligjor dokumentacionin e kërkuar për realizimin e angazhimit, Bordi aplikon sanksionin administrativ nga 10,000 Lekë deri në 500,000 Lekë ndaj anëtarëve të këtyre organeve përgjegjës për shkelje.

Kur shkeljet kanë një rëndësi të veçantë, Bordi i Mbikqyrjes Publike mund të ndalojë përkohësisht, për një periudhë jo më të gjatë se tre vjet, anëtarët e organeve të drejtimit d për shkelje nga ushtrimi i funksioneve të Njësie Ekonomike me interesit publik.

1.10 Kur Bordi i Mbikqyrjes Publike konstaton moszbatimin ose mirëmbajtjen jo në përputhje me ligjin nga audituesi ligjor dhe shoqëria e auditimit të një sistemi të brendshëm të raportimit në përputhje me kërkesat mbi Sistemet e brendshme të raportimit të shkeljeve të ligjit, Bordi i Mbikqyrjes Publike mund të aplikojë sanksionin administrativ të parashikuar nën paragrafin 1.1 gërma a).

Në raste të vogla ose të rënda, aplikohen nënparagrafin 1.3 dhe 1.4.

Neni 55/4 -Sistemet e brendshme të raportimit të shkeljeve

1. Shoqëritë e auditimit duhet të adoptojnë procedura specifike për raportimin brenda tyre, nga personeli, të veprimeve ose faktorëve që mund të përbëjnë shkelje potenciale ose reale të disiplinës në fushën e auditimit ligjor.

2. Procedurat e parashikuara në paragrafin 1 duhet të jenë të përshtatshme për të garantuar:

- Konfidencialitetin e të dhënave personale të raportuesit dhe të personit të dyshuar për shkelje, duke respektuar rregullat që rregullojnë hetimet ose procedurat e nisura nga autoriteti gjyqësor lidhur me faktet e raportimit; identiteti i raportuesit nuk mund të zbulohet gjatë të gjitha fazave të procedurës, përveç në rastet e miratimit të tij ose kërkesës specifike të autoritetit gjyqësor.
- Mbrojtjen e duhur të raportuesit nga veprimet hakmarrëse, diskriminuese ose të tjera të padrejta që mund të pasojnë pas raportimit.
- Kanalin specifik, të pavarur dhe autonome për raportimin.
- të drejtën e personit të dyshuar për shkelje për të dëgjuar para marrjes së çdo vendimi në lidhje me të, përveç të gjitha të drejtave të tij të mëtejshme për mbrojtje.

3. Paraqitja e një raportimi në kuadër të procedurës së parashikuar në paragrafin 1 nuk përbën shkelje të detyrimeve të lindura nga marrëdhëniet e punës, përveç rasteve të raportimeve të bëra me dashje të keqe ose me informacione të rreme.

Këto sanksione do të zbatohen brenda 3 viteve nga kryerja e shkeljes.

2. ~~Shkeljet administrative dhe disiplinore, për të cilat jepen sanksione administrative, siç parashikohet në pikën (1) të këtij neni, janë si më poshtë:~~

- a) ~~shkelje e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në këtë ligj dhe në statutin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë;~~
b) ~~mosrespektimi i legjisllacionit në fuqi për aktivitetet e deleguara sipas aktit të delegimit.~~

Neni 21

Neni 57/1 ndryshon si më poshtë:

1. ~~Nëse Aktet administrative të nxjerra nga BMP, nuk janë ankimuar për rishikim sipas pikës 2 të këtij neni, janë objekt i të drejtës së ankimit në gjykatën administrative kompetente në vendin ku ka selinë BMP, brenda afateve dhe procedurave të kodit të procedurave administrative.~~

2. ~~Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë BMP, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të BMP në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.~~

Neni 22

Neni 58 shfuqizohet.

Neni 21

Neni 57/1 ndryshon si më poshtë:

1. Kundër vendimit të aplikimit të sanksioneve të parashikuara në nenit 55 dhe 55/1, lejohet apelimi në Gjykatën Administrative, ku ka selinë shoqëria e auditimit ose Audituesi ligjor që ka kryer shkeljen, ose, në rastet kur ky kriter nuk është i zbatueshëm, të vendit ku është kryer shkelja.

2. Apeli duhet t'i njoftohet Bordit të Mbikqyrjes Publike brenda tridhjetë ditësh nga komunikimi dhe duhet të depozitohet në kancelarinë e Gjykatës brenda tridhjetë ditësh nga njoftimi.

3. Apeli nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Gjykata nëse ekzistojnë arsye të forta, mund të vendosë pezullimin e vendimit.

4. Kopja e vendimit dërgohet të Gjykatës pranë Bordit të Mbikqyrjes Publike për qëllime të publikimit në faqen e internetit të Bordit.

Neni 22

Neni 58 shfuqizohet.

4. Bordi i Mbikqyrjes Publike jep udhëzimet zbatuese të këtij artikulli, pas dëgjimit të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë dhe i Shoqërive të Auditimit.

Neni 55/5 – Mashtrimi në raportet apo komunikimet e përgjegjësve të auditimit ligjor

1. Përgjegjësit e auditimit ligjor të cilët, me qëllim që për veten ose për të tjerë të sigurojnë një përfitim të padrejtë, në raportet ose komunikimet tjera, me vetëdije dhe me qëllim për të mashtruar marrësin e komunikimeve, dëshmojnë të pavërtetën ose fshehin informacione lidhur me situatën ekonomike, pasurore ose financiare të shoqërisë, entit apo subjektit nën auditim, në një mënyrë që mund të sjellë marrjen e vendimeve të gabuara nga marrësi i komunikimeve në lidhje me situatën e mësipërme, denoncohen penalisht nga Bordi i Mbikqyrjes Publike dhe/ose Organizata profesionale e Audituesve dhe i Shoqërive të Auditimit pranë prokurorisë së rrethit gjyqësor në të cilën zhvillon aktivitetin audituesi.

Neni 55/6 - Korrupsioni gjatë angazhimit të auditimit ligjor

1. Përgjegjësit e auditimit ligjor, të cilët, si rezultat i dhënies ose premtimit së një përfitimi, për veten o për një të tretë, kryejnë ose neglizhojnë veprime, në kundërshtim me detyrimet e tyre zyrtare, duke shkaktuar dëme shoqërisë, përgjegjen personalisht në përputhje me legjisllacionin penal në fuqi.

2. Përgjegjësi i auditimit ligjor dhe anëtarët e organeve të administratës, bashkëpunorët dhe punonjësit e shoqërisë së auditimit ligjor, të cilët, gjatë ushtrimit të auditimit ligjor të Njësive me Interes interes publik me qëllim përfitimin në para ose përfitime të tjera të dhëna ose të premtuara, kryejnë ose neglizhojnë veprime në kundërshtim me detyrimet zyrtare janë përgjegjen personalisht në përputhje me legjisllacionin penal në fuqi.

Neni 55/7- Pengesë gjatë auditimit

1. Anëtarët e organeve drejtuese që, duke fshehur dokumente ose me fakte të tjerë të përshtatshme, pengojnë ose ndërhyjnë në çdo mënyrë për të parandaluar zbatimin e veprimeve të auditimit ligjor, dhe sanksionohen nga Bordi me gjobë deri në pesëdhjetë e pesë mijë Lekë .

2. Nëse sjellja e përmendur në paragrafin 1 ka shkaktuar dëme për aksionerët ose të tretë, dhe sanksionohen nga Bordi me një gjobë deri në pesëdhjetë e pesë mijë Lekë.

3. Në rastin e auditimit ligjor të njësive ekonomike me interes publik dënimet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 dyfishohen.

Neni 55/8- Pagesa e paligjshme

1. Përgjegjësi i auditimit ligjor dhe anëtarët e organeve drejtuese, aksionerët dhe punonjësit e shoqërisë së auditimit ligjor, të cilët marrin, drejtpërdrejtë ose indirektë nga shoqëria që i nënshtrohet auditimit ligjor, pagesa në para ose në formë të tjera, përveç atyre që janë të paktën në marrëveshje të ligjshme, janë përgjegjes personalisht në përputhje me legjisllacionin penal në fuqi, dhe sanksionohen nga Bordi me gjobë nga një mijë Lekë deri në njëqind mijë Lekë.

2. Paragrafi 1 aplikohet për anëtarët e organeve drejtuese dhe likuidatorët e shoqërisë ndaj të cilave realizohet auditimi ligjor dhe që kanë paguar pagesën e paligjshme.

Neni 55/9- Marrëdhëniet e paligjshme financiare me shoqërinë ndaj të cilës realizohet auditimi ligjor

1. Administratorët, ortakët përgjegjës për auditimin ligjor dhe punonjësit e shoqërisë së auditimit që marrin huamarrje në çdo formë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes një personi tjetër, nga shoqëria ndaj të cilës po realizon auditimit ose ndaj një shoqëri që e kontrollojnë atë, ose që është e kontrolluar nga ajo, ose marrin garanci për detyra të tyre nga një prej këtyre shoqërive, janë përgjegjes personalisht në përputhje me legjisllacionin penal në fuqi dhe

		sanksionohen nga Bordi me një gjobë nga dhjete mijë Lekë deri në pesëshjete mire Lekë. Neni 55/10 - Dispozitat e përbashkëta 1. Për veprimet e mundshme të vlerësimit nga organet e drejtësisë, Autoriteti gjyqësor përgjegjës për veprimin përkatës, duhet të njoftojë Bordin e Mbikqyrjes Publike, informacion në lidhje me kundër cilëve personave të regjistruar në regjistrin e audituesve ligjorë dhe shoqëriv etë auditimit: a) është ushtruar veprim penal; b) është caktuar zbatimi i masave parandaluese ose siguruese; c) janë dhënë vendime gjyqësore që përcaktojnë gradën e gjykimit.
--	--	--

5. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 kreu V Auditimi Ligjor i Pasqyrave Financiare, Emërimi dhe shkarkimi i Audituesit Ligjor dhe i Shoqërisë së Auditimit

- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 16) Sjell ndryshime në Neni 42: Emërimi i audituesve ligjorë ose i shoqërive audituese**

Propozimi 17 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 16 i Projekt-Ligj Nr. /2024

Ndryshimet e paraqitura në nenin 42 paraqesin kushtet e emërimit të audituesve ligjorë ose i shoqërive audituese përkatësisht

- afatet e emërimit,
- ndalimet,
- afatet kohore të rotacionit të ortakut të angazhimit të një njësie ekonomike,
- kriteret për pranimin e angazhimit

Megjithë përmirësimet e dukshme që sjell ky ndryshim mendojmë që ka ende vend për ndryshime të metejshme të cilat do të sigurojnë:

- ndarjen e emërimit nga marrja e angazhimit
- kohëzgjatja e emërimit të jëtë e njëjtë me mandatin e komiteti të auditimit osë të këshillave drejtues/mbikqyrës/administratorëve, me qëllim që të sigurohet vijueshmëri në buxhetet dhe planet ekonomike financiare të audituesit dhe shoqërisë së auditimit
- rotacioni i ortakut të angazhimit të jëtë real;

si rrjedhojë lutemi gjeni ndryshimet e propozuara nga IEKA

ISHTË

Neni 16

Në nenin 42 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1.Pika 1, ndryshon si më poshtë vijon:

~~“1.Audituesi ligjor ose shoqëria audituese emërohet çdo vit nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve për shoqëritë aksionare, nga asambleja e ortakëve për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, dhe/ose nga ndonjë organ tjetër i ngarkuar për këtë qëllim nga kuadri ligjor në fuqi.~~

Ndalohet çdo klauzolë kontraktuale dhe/ose ligjore që kufizon emërimin nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve/ortakëve dhe/ose nga organe të tjerë të njësisë ekonomike të audituara, për disa kategori ose lista audituesish ose shoqërish audituese, në lidhje me emërimin e një audituesi ligjor ose shoqërie audituese të caktuar për të kryer auditimin ligjor apo dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të asaj njësie ekonomike. Çdo klauzolë e tillë në kontratat ekzistuese do të konsiderohet e pavlefshme.

2.Pika 2 ndryshon si më poshtë vijon:

~~“2. Audituesi ligjor që ushtron profesionin i vetëm dhe audituesi ligjor kryesor ose ortaku kryesor i auditimit në një shoqëri audituese, që është audituesi ligjor përgjegjës për kryerjen e angazhimit të auditimit në emër të shoqërisë audituese, duhet të zëvendësohet për kryerjen e auditimit brenda një periudhe maksimale prej 7 vjetësh nga data e fillimit si auditues ligjor.~~

~~Ai mund të marrë pjesë sërish në auditimin e së njëjtës njësie ekonomike pas kalimit të një periudhe prej të paktën tre vjetësh nga zëvendësimi i tij/saj, me kusht që periudha kohore e përgjithshme e angazhimit të mos kalojë shtatë vjet.”~~

BEHET

Neni 16

Në nenin 42 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1.Pika 1, ndryshon si më poshtë vijon:

~~“1.Audituesi ligjor ose shoqëria audituese emërohet nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve për shoqëritë aksionare, nga asambleja e ortakëve për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, dhe/ose nga ndonjë organ tjetër i ngarkuar për këtë qëllim nga kuadri ligjor në fuqi, për një mandat jo më pak se 3 vjeçar.~~

Audituesi ligjor ose shoqëria audituese sigurohen çdo vit që të rishikojnë kushtet e angazhimit dhe të realizojë procedurat përkatëse në lidhje me pranimin e tij.

Ndalohet çdo klauzolë kontraktuale dhe/ose ligjore që kufizon emërimin nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve/ortakëve dhe/ose nga organe të tjerë të njësisë ekonomike të audituara, për disa kategori ose lista audituesish ose shoqërish audituese, në lidhje me emërimin e një audituesi ligjor ose shoqërie audituese të caktuar për të kryer auditimin ligjor apo dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të asaj njësie ekonomike.

Çdo klauzolë e tillë në kontratat ekzistuese do të konsiderohet e pavlefshme.

2.Pika 2 ndryshon si më poshtë vijon:

~~“2. Audituesi ligjor që ushtron profesionin i vetëm dhe shoqëria e auditimit, duhet të zëvendësohet për kryerjen e auditimit brenda një periudhe maksimale prej 7 vjetësh nga data e fillimit si auditues ligjor.~~

~~Audituesi ligjor mund të marrë pjesë sërish në auditimin e së njëjtës njësie ekonomike pas kalimit të një periudhe prej të paktën tre vjetësh nga zëvendësimi i tij/saj, me kusht që periudha kohore e përgjithshme e angazhimit të mos kalojë shtatë vjet.”~~

Shoqëria e auditimit mund të marrë pjesë sërish në auditimin e së njëjtës njësie ekonomike pas kalimit të një periudhe prej të paktën 1 vit nga zëvendësimi i tij/saj, me kusht që ortakut i angazhimit të jëtë i ndryshëm nga ai i periudhave të mëparshme dhe periudha kohore e përgjithshme e angazhimit të mos kalojë shtatë vjet.”

3.Pika 3 ndryshon si më poshtë vijon:

3. Pika 3 ndryshon si më poshtë vijon:

“3. Autoritetet mbikëqyrëse të tregjeve të rregulluara me ligj të veçantë mund të parashikojnë kritere shtesë, të cilat duhet të plotësohen nga audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese që do të kryejnë auditimin e njësive ekonomike të mbikëqyrura prej tyre.”.

4. Pika 4, ndryshon si më poshtë vijon:

“4. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit nuk duhet të pranojë angazhimin e auditimit, nëse vendimi i emërimit i përmendur në këtë nen, nuk është në përputhje me kërkesat e këtij neni dhe kushtet e tjera të kryerjes së angazhimit të auditimit, të përcaktuara në këtë ligj.”.

“3. Autoritetet mbikëqyrëse të tregjeve të rregulluara me ligj të veçantë mund të parashikojnë kritere shtesë, të cilat duhet të plotësohen nga audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese që do të kryejnë auditimin e njësive ekonomike të mbikëqyrura prej tyre.

4. Pika 4, ndryshon si më poshtë vijon:

“4. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit nuk duhet të pranojë angazhimin e auditimit, nëse vendimi i emërimit i përmendur në këtë nen, nuk është në përputhje me kërkesat e këtij neni dhe kushtet e tjera të kryerjes së angazhimit të auditimit, të përcaktuara në këtë ligj.

Shtohet pika 5

5.1 Në rast të mos zbatimit të dispozitave të këtij neni nga audituesit dhe shoqëritë e auditimit aplikohen sanksionet në përputhje me neni 55.

5.2 Në rast të mos zbatimit të dispozitave të këtij neni nga organet drejtuese dhe administratorët e shoqërive objekt auditimit aplikohen sanksione ndaj tyre në masën nga pesëdhjetë mijë deri në pesëqind mijë lekë.

6. Ndryshimet e Propozuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 kreu VI Dispozita të veçanta për Auditimi Ligjor të Njesive me Interes Publik

- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 17) Sjell ndryshime në Neni 46: Komiteti i Auditimit i Personave Juridikë**
- **Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 18) Sjell shtesa në Neni 46: Komiteti i Auditimit i Personave Juridikë**

Propozimi 18 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 17 i Projekt-Ligj Nr. /2024

Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 17)

Sjell ndryshime në Neni 46: Komiteti i Auditimit i Personave Juridikë

Projekt-Ligji sjell një ndryshim në lidhje me organet mbikëqyrëse të shoqërive NjEIP duke përfshirë në strukturën rganizative të tyre komitetin e auditimit, dhe siguruar që ky i fundit të jëtë i që është ose i pavarur ose pjesë e organit administrativ ose mbikëqyrës të njësive ekonomike të audituar.

Me tej neni sjell informacion në lidhje me përbërjen e këtij komiteti, numrin e anëtarëve, profilin profesional të tyre dhe detyrat që përfshijnë informimin, monitorimin e procesit të raportimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, dhe pavarësisë së shoqërive audituese.

Gjithashtu ku nen i njëh komiteti të drejtën për të kryer procedurën e përzgjedhjes së shoqërisë audituese dhe e rekomandon atë për emërim.

Sa këto përcaktime, vërejmë rregullimet e mesipërme janë të natyrës të udheheqjes së shoqërive dhe ti të tilla objekt i legjislacionit përkatës që rregullon shoqëritë tregtare .

Si rrjedhojë rekomandojme shfuqizimin tërësor të nenit 46 dhe përfshirjen e kërkesave të Direktivës dhe Rregullores të BE në ligjin “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

- Ky kalim do të evitojë interferencat që sjell ky nen i ligjit të auditimit me legjislacionin për Bankat në Republikën e Shqipërisë, Shoqëritë e Sigurimit dhe Risigurimit, Institucionet Financiare JoBankat etj, dhe Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar të njësive publike, të cilat kanë të inkuorporuar që në gjenezën e tyre komitetet, të cilët funksionojnë në bazë të detyrave sipas ligjit dhe rregulloret përkatëse të BoA dhe AMF.
- Është në linjë me legjislacion European në lidhje me Auditmin Ligjor

Propozimi 19 IEKA: Ndryshimi i Propozuar Neni 18 i Projekt-Ligj Nr. /2024**Propozimi: Projekt-Ligj Nr. /2024 (Neni 18)****Sjell shtesa në Neni 46: Komiteti i Auditimit i Personave Juridikë duke shtuar neni 46/1****Rishikimi i kontrollit të cilësisë së angazhimit**

Nga një analizë e realizuar me direktiven, rregullores dhe pjesës takuese të ligjit të vendeve europiane **veçojmë që neni 18, i propozuar në këtë projekt-ligj ka një qasje më të specializuar dhe të përqendruar në rishikimin e cilësisë së angazhimit për çdo raport specifik auditimi.**

Ndërkaq që ne mendojmë që ndryshimet e realizuar në nenin 38 dhe 39 plotësojnë kërkesat e legjislacionit europian në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë dhe sigurine e sistemit të cilësisë, tendenca për këtë qasje për rishikim të cilësisë së angazhimit për çdo raport specifik auditimi.

Sa më lart lë të nënkuptohet që për audituesit ligjorë (2023: 167) të cilët realizojnë angazhimet si persona fizikë, **në këto kushte janë të detyruar të angazhojnë për çdo angazhim një auditues për rishikimin e tyre.**

Kjo do të shkaktojë kosto shtesë auditimit të cilat, ashtu si e kemi përmendur në seksionet më lart janë jo të qëndrueshme.

Duke qënë që standardet e auditimit, dhe standardet e menaxhimit të kontrollit të cilësisë janë mjaftueshme të qartë në lidhje me detyrimet që kanë audituesit në lidhje me procesin e rishikimit të cilësisë dhe menaxhimit të procesit, mendojmë që ky nen është **përsëritje e kërkesave të standardit të cilësisë, mbart përshkrime teknike**, të cilat janë të përshtatshme për përpilimin e manualeve dhe rregulloreve.

Si rrjedhojë rekomandojmë mos marrjen në konsideratë të nenit 18.

Ndërkaq që në rast se autoritetet mendojnë që të mbajnë këtë propozim lutemi gjeni propozimin përkatës, ndërkaq që sygjerojmë që ky nen të përfshihet në vijim te neni Neni 38: Sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë

ISHTE

Neni 46/1

Rishikimi i kontrollit të cilësisë së angazhimit

- ~~1. “Para lëshimit të raportit të auditimit dhe raportit shtesë për komitetin e auditimit, duhet të realizohet një rishikim i kontrollit të cilësisë së angazhimit, për të vlerësuar nëse audituesi ligjor ose ortaku kryesor i auditimit, kanë formuar në mënyrë të arsyeshme opinionin dhe konkluzionet e shprehura në draftin e këtyre raporteve.~~
- ~~2. Rishikimi do të kryhet nga një rishikues i kontrollit të cilësisë së angazhimit. Rishikuesi duhet të jetë një auditues ligjor, i cili nuk ka është i përfshirë në kryerjen e auditimit ligjor subjekt i rishikimit.~~
3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, kur auditimi ligjor kryhet nga një shoqëri audituese dhe të gjithë audituesit ligjorë kanë qenë të përfshirë në kryerjen e auditimit ligjor, ose kur auditimi ligjor është kryer nga një auditues ligjor, i cili nuk është ortak ose punonjës i një shoqërie audituese, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të marrin masat që rishikimi të kryhet nga një tjetër auditues ligjor. Për qëllimet e këtij neni, dhënia e dokumentacionit apo informacionit rishikuesit të pavarur, nuk përbën shkelje e dispozitave për ruajtjen e konfidencialitetit dhe sekretit profesional. Dokumentacioni apo

BEHET - Neni 38/1**Rishikimi i sistemit të cilësisë së angazhimit të auditimit**

1. Rishikimi i cilësisë së angazhimit kryhet në nivel angazhimi nga Rishikuesi i cilësisë së angazhimit i cili realizohet për llogari të Shoqërisë së auditimit dhe/ose Audituesit Ligjor.
2. Rishikimi i cilësisë së angazhimit është një vlerësim objektiv i gjykimeve të rëndësishme të bëra nga ekipi i angazhimit dhe i përfundimeve të arritura përgjatë angazhimit.
3. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit nuk është anëtar i ekipit të angazhimit.
4. Kryerja e rishikimit të cilësisë së angazhimit nuk ndryshon përgjegjësitë e ortakut të angazhimit dhe/ose audituesit ligjor për menaxhimin dhe arritjen e cilësisë mbi angazhimin, ose për drejtimin dhe mbikëqyrjen e anëtarëve të ekipit të angazhimit dhe rishikimin e punës së tyre.
5. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit nuk është i detyruar të grumbullojë evidencë për të mbështetur mendimin apo përfundimin mbi angazhimin, por ekipi i angazhimit dhe/ose audituesi ligjor mund të grumbullojë evidencë të mëtejshme në përgjigje të çështjeve të ngritura gjatë rishikimit të cilësisë së angazhimit.
6. Shoqëria e auditimit dhe Audituesit Ligjorë duhet të përcaktojnë kushtet për
 - a. caktimin dhe kushtet që duhet të plotësojë Rishikuesi i cilësisë së angazhimit; dhe
 - b. përgjegjësitë e Rishikuesit të cilësisë së angazhimit që kanë të bëjnë me performancën dhe dokumentacionin e një Rishikimi i cilësisë së angazhimit.
 - c. në rastin e angazhimit të Rishikuesit të cilësisë së angazhimit nga shoqëria e auditimit dhe audituesi ligjor, për qëllimet e këtij neni dhënia e dokumentacionit apo informacionit rishikuesit, nuk përbën shkelje e dispozitave për ruajtjen e konfidencialitetit dhe sekretit

informacioni që i ofrohet rishikuesit për qëllimet e këtij neni do t'i nënshtrohen sekretit profesional.

4. Gjatë kryerjes së rishikimit, rishikuesi duhet të paktën të dokumentojë të dhënat për sa më poshtë vijon:
- a) informacionin e siguruar, verbalisht dhe me shkrim, nga audituesi ligjor ose ortaku kryesor i auditimit në mbështetje të gjykimeve të rëndësishme, gjetjet kryesore nga kryerja e procedurave të auditimit, si dhe konkluzionet e nxjerra nga këto gjetje, pavarësisht nëse kërkohet apo jo nga rishikuesi;
 - b) opinionet e audituesit ligjor ose të ortakut kryesor të auditimit, ashtu siç shprehen në draftin e raporteve të përmendura në pikën 1 të këtij neni;
5. Rishikimi duhet të vlerësojë së paku elementët e mëposhtëm:
- a) pavarësinë e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese nga njësia ekonomike e audituar;
 - b) rreziqet e rëndësishme që lidhen me auditimin ligjor dhe që audituesi ligjor ose ortaku kryesor i auditimit, ka identifikuar gjatë kryerjes së auditimit dhe masat që ai ka marrë për t'i adresuar në mënyrë të përshtatshme këto rreziqe;
 - c) gjykimin profesional të audituesit ligjor ose ortakut kryesor të auditimit, veçanërisht në lidhje me nivelin e materialitetit dhe rreziqet e rëndësishme të përmendura në pikën (b);
 - ç) çdo kërkesë për këshillim drejtuar ekspertëve të jashtëm dhe zbatimin e këtyre këshillave;
 - d) natyrën dhe përhapjen e anomalive, të korrigjuara ose jo, të identifikuara në pasqyrat financiare gjatë kryerjes së auditimit;
 - dh) çështjet e diskutuara me komitetin e auditimit dhe organet drejtuese dhe/ose mbikëqyrëse të njësive ekonomike të audituar;
 - e) çështjet e diskutuara me autoritetet
- profesional. Dokumentacioni apo informacioni që i ofrohet rishikuesit për qëllimet e këtij neni do t'i nënshtrohen sekretit profesional.
7. Politikat apo procedurat mbi Sistemet e Sigurimit të Cilësisë të shoqërive të auditimit dhe audituesit ligjor duhet të ndalojnë ortakun e angazhimit apo audituesin ligjor të dalë me raportin e angazhimit deri në përfundimin e Rishikimit të Cilësisë së Angazhimit, i cili përfshin dhe zgjidhjen e çështjeve të ngritura nga Shqyrtuesi i Cilësisë së Angazhimit. Me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kërkesat në lidhje me ecurinë e rishikimit të cilësisë së angazhimit, dokumentacioni i rishikimit mund të finalizohet pas datës së raportit të angazhimit, por para përgatitjes së dosjes përfundimtare të angazhimit. Megjithatë, politikat apo procedurat e shoqërive të auditimit dhe/ose audituesit ligjor mund të specifikojnë se dokumentacioni i rishikimit të cilësisë së angazhimit duhet të finalizohet në datën ose para datës së raportit të angazhimit.
8. Vlerësimi nga ana e Rishikuesi të cilësisë së angazhimit të gjykimeve të rëndësishme kryhet në kuadrin e standardeve profesionale dhe kërkesave të zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Megjithatë, një rishikim i cilësisë së angazhimit nuk ka për qëllim të jetë një vlerësim nëse i gjithë angazhimi përputhet me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, apo me politikat apo procedurat e shoqërisë së auditimit dhe audituesit ligjor.
9. Rishikuesi i diskuton rezultatet e rishikimit me audituesin ligjor ose ortakun kryesor të auditimit. Shoqëria audituese dhe/ose audituesi ligjor duhet të përcaktojë procedurat për mënyrën e zgjidhjes së çdo mosmarrëveshje ndërmjet ortakut kryesor të auditimit dhe rishikuesit.
10. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit duhet të njoftojë ortakun e angazhimit dhe/ose audituesin ligjor nëse Rishikuesi i cilësisë së angazhimit ka shqetësime se gjykimet e rëndësishme të bëra nga ekipi i angazhimit, apo përfundimet e arritura nuk janë të përshtatshme. Nëse këto shqetësime nuk zgjidhen nga ekipi i angazhimit dhe/ose audituesi ligjor që ti përshtaten kërkesave të Rishikuesit, atëherë Rishikuesi i cilësisë së angazhimit duhet të njoftojë se shqyrtimi i cilësisë së angazhimit nuk mund të përfundojë.
11. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit do të përcaktojë nëse kërkesat e sistemit të sigurimit të cilësisë në lidhje me realizimin e rishikimit të cilësisë së angazhimit janë përmbushur dhe nëse rishikimi i cilësisë së angazhimit është i plotë. Nëse po, rishikuesi i cilësisë së angazhimit duhet të njoftojë ortakun e angazhimit dhe/ose audituesin ligjor se rishikimi i cilësisë së angazhimit është i plotë.
12. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit duhet të përfshijë në dokumentacioni i rishikimit të cilësisë së angazhimit, informacion të mjaftueshëm, për t'i mundësuar një audituesi ligjor me përvojë, dhe që nuk ka pasur asnjë lidhje të mëparshme me angazhimin, për të kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të kryera nga shqyrtuesi i cilësisë së angazhimit dhe, kur është e zbatueshme, individët që kanë ndihmuar shqyrtuesin dhe përfundimet e arritura në kryerjen e shqyrtimit.
13. Rishikimi duhet të vlerësojë së paku elementët e mëposhtëm:
- a) pavarësinë e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese nga njësia ekonomike e audituar;
 - b) rreziqet e rëndësishme që lidhen me auditimin ligjor dhe që audituesi ligjor ose ortaku kryesor i auditimit, ka identifikuar gjatë kryerjes së auditimit dhe masat që ai ka marrë për t'i adresuar në mënyrë të përshtatshme këto rreziqe;
 - c) gjykimin profesional të audituesit ligjor ose ortakut kryesor të auditimit, veçanërisht në lidhje me nivelin e materialitetit dhe rreziqet e rëndësishme të përmendura në pikën (b);
 - ç) çdo kërkesë për këshillim drejtuar ekspertëve të jashtëm dhe zbatimin e këtyre këshillave;
 - d) natyrën dhe përhapjen e anomalive, të korrigjuara ose jo, të identifikuara në pasqyrat financiare gjatë kryerjes së auditimit;
 - dh) çështjet e diskutuara me komitetin e auditimit dhe organet drejtuese dhe/ose mbikëqyrëse të njësive ekonomike të audituar;
 - e) çështjet e diskutuara me autoritetet
- profesional. Dokumentacioni apo informacioni që i ofrohet rishikuesit për qëllimet e këtij neni do t'i nënshtrohen sekretit profesional.

- kompetente dhe, sipas rastit, me palë të treta;
ë) nëse dokumentacioni dhe informacionet e dosjes së auditimit, të përzgjedhura nga rishikuesi, mbështesin opinionin e audituesit ligjor ose të ortakut kryesor të auditimit të shprehur në draftin e raporteve të përmendura në pikën 1 të këtij neni.
6. Rishikuesi i diskuton rezultatet e rishikimit me audituesin ligjor ose ortakun kryesor të auditimit. Shoqëria audituese duhet të përcaktojë procedurat për mënyrën e zgjidhjes së çdo mosmarrëveshje ndërmjet ortakut kryesor të auditimit dhe rishikuesit.
- ~~7. Shoqëria audituese dhe rishikuesi duhet të dokumentojnë rezultatet e rishikimit, së bashku me gjykimin profesional në bazë të këtyre rezultateve.”~~
- përmendura në pikën 1 të këtij neni.
14. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit duhet të dokumentojë sa më poshtë:
a) Emrin/at e Rishikuesit/ve të cilësisë së angazhimit dhe individëve që ndihmojnë në shqyrtimin e cilësisë së angazhimit;
b) Një identifikim të dokumentacionit të angazhimit të shqyrtuar;
c) Baza për përcaktimin e kërkesave të rishikuesit të cilësisë së angazhimit në përputhje me pikën 11);
d) Njoftimet e realizuara në përputhje me pikën 10 dhe 11); dhe
e) Datën e përfundimit të rishikimit të cilësisë së angazhimit.
15. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit duhet të dokumentojë procedurat e rishikimit dhe njoftimin e përfundimit të rishikimit nëpërmjet
a) përdorimit të sistemeve të informacionit që përdoren për angazhimin;
b) memo përmbledhësë;
c) procesverbaleve të takimeve mbi diskutimet e rishikuesit me ekipin të angazhimit.

Propozimi 20 IEKA: Ndryshimi i Propozuar nga IEKA Neni 15 pika 2 gërma c fjalia e parë dhe e dytë

Sjell shtesa në Neni 15 : Praktika profesionale dhe hyrja në profesion pika 2 gërma c fjalia e parë dhe e dytë

Në kushtet e pranimit të gjërësishëm të ISA ashtu si janë publikuara nga IAASB dhe përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë European në të gjitha shtyllat e integritetit, vërejmë që kufizimi i praktikës profesionale pranë një shoqërie të rrëgjistruar në Shqipëri, kufizon mundësitë dhe hapësirat e kandidatëve për të përfutur dije dhe ekperiencë e cila tejkalon atë shqiptare.

Si rrjedhojë e shohim të udhës që neni 15 i cili përmban 2 barrierë në formimin profesional të kandidatëve të ndryshohet me qëllim reduktimin e barrierave që ky ligj ka vendosur.

Ky rekomandim ofrohet bazuar dhe eliminimet më të hershëm të barrierave në ligj:

- Njohja e përjashtimit nga disa nga provimet e kualifikimit për shtetasit e huaj: neni 18 pika 10;
- Regjistrimi i shoqërive të huaja të auditimit: Neni 2, pika 21;
- Regjistrimi i Audituesve Ligjorë të juridiksioneve të huaja: neni 22;
- Njohja e edukimit profesional të realizuar nga shtetasit shqiptarë pranë palëve të treta jo IEKA; Neni 15, pika 7

Sa më sipër rekomandimi i ynë paraqitet sa vijin:**ISHTE**

Neni 15 pika 1 gërma c)

1. Përpara se të testohet në provimin përfundimtar për marrjen e titullit “Auditues ligjor”, me qëllim që të regjistrohet në regjistrin publik të audituesve ligjorë, kandidati duhet të ketë:

- a) përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë ligj për hyrjen në profesion;
- b) kaluar me sukses të gjitha testet e parashikuara në programin e përgatitjes profesionale, të hartuara në zbatim të nenit 18 të këtij ligji;
- c) kryer gjysmën e praktikës profesionale, e cila zgjat në total 3 vjet, në kushtet e punësimit me kohë të plotë në auditimin e pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara ose pasqyrave financiare të tjera, të ngjashme, pranë një audituesi ligjor ose shoqërie auditimi ~~të njohur në Republikën e Shqipërisë~~, që dallohet për reputacion të mirë dhe nën udhëheqjen e audituesve ligjorë që kanë garancitë e mjaftueshme për këtë qëllim.

~~Të paktën, dy të tretat e kësaj praktike profesionale duhet të kryhen pranë një audituesi ligjor ose një shoqërie audituese, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.~~

BEHET

Neni 15 pika 1 gërma c)

1. Përpara se të testohet në provimin përfundimtar për marrjen e titullit “Auditues ligjor”, me qëllim që të regjistrohet në regjistrin publik të audituesve ligjorë, kandidati duhet të ketë:

- a) përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë ligj për hyrjen në profesion;
- b) kaluar me sukses të gjitha testet e parashikuara në programin e përgatitjes profesionale, të hartuara në zbatim të nenit 18 të këtij ligji;
- c) kryer gjysmën e praktikës profesionale, e cila zgjat në total 3 vjet, në kushtet e punësimit me kohë të plotë në auditimin e pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara ose pasqyrave financiare të tjera, të ngjashme, pranë një audituesi ligjor ose shoqërie auditimi të regjistruar pranë regjistrit të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit në Republikën e Shqipërisë ose në një nga vendet anëtare të Bashkimit European, që dallohet për reputacion të mirë dhe nën udhëheqjen e audituesve ligjorë që kanë garancitë e mjaftueshme për këtë qëllim.

Propozimi 20 IEKA: Ndryshimi i Propozuar nga IEKA Neni 18 pika 3

Ndërkaq që një barriere shtesë e vendosur, ne hyrjen në profesionin është përfshirë në nenin 18 Provimi i aftësive profesionale pika 3 - Sistemi i testimi duhet të mbulojë, në masën që këto i interesojnë auditimit ligjor, edhe disiplinat sipas pikës gërma a-g)

Ne gjejmë që kjo përfshirje në provimet e hyrjes në nuk sjell asnjë vlerë të shtuar në krahasim me pikën 2, 4 dhe 5 dhe standardeve ndërkombëtare të Edukimit të cilat janë përqafuar në nenin 18 pika 2.

Si rrjedhojë propozojmë që neni 18 të mbartë ndryshimet bazuar në sa vijon:

ISHTE**Neni 18 pika 3**

~~3. Sistemi i testimi duhet të mbulojë, në masën që këto i interesojnë auditimit ligjor, edhe disiplinat e mëposhtme:~~

- ~~a) legjislacioni për shoqëritë tregtare dhe qeverisja e shoqërive tregtare;~~
- ~~b) legjislacioni dhe procedurat e falimentimit;~~
- ~~c) legjislacioni fiskal në Republikën e Shqipërisë;~~
- ~~d) e drejta civile;~~
- ~~e) legjislacioni për sigurimet shoqërore dhe e drejta e punës në Republikën e Shqipërisë;~~
- ~~f) teknologjia e informacionit dhe sistemet kompjuterike;~~
- ~~g) ekonomiks;~~
- ~~h) matematikë dhe statistikë;~~
- ~~i) parimet bazë të menaxhimit financiar.~~

~~Programi i përgatitjes profesionale hartohet çdo vit nga organizata profesionale e audituesve ligjorë.~~

BEHET**Neni 18 pika 3**

Pika 3. shfuqizohet